

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7795 E shtunë 16 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Analiza **e** Ditës

Qendra Shqiptare për Qeverisje të Mirë publikoi sondazhin e vitit 2018, sipas të cilit papunësia është shqetësimi kryesor i qytetarëve, krahas korrupsionit ...
Vijon në faqen 20

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

Pa punë, pa kursime, pa shpresa, gati për mërgim



Opinion **i** Ditës

Nga BEN ANDONI

Nëse Shqipëria do të ishte në hartën e protestave kontinentale, atëherë duhej të konsiderohej si një ogur i mirë. Kjo do të thoshte se ne ishim në një ..
Vijon në faqen 21

"Nano ik", "Berisha ik", "Rama ik", cili do të qëndrojë?!



Procedura për të bërë sigurim vullnetar

ISSH: Pensionet e pleqërisë, ja si të përfitoni më shumë të ardhura

Instituti i Sigurimeve publikon skemën për derdhjen e kontributeve për ata që s'plotësojnë vitet e punës

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë të moshuarit që nuk i kanë plotësuar vitet e përcaktuara të punës me kontribute për të marrë pension apo të përfitojnë një masë më të lartë të tij mund të aplikojnë për sigurimin vullnetar. Sot, "Gazeta Shqiptare" publikon ...
Në faqen 11

PLANI, QYTETARET NE SHESH PA AFAT. BASHA: EDI RAMA PARA DREJTESISË

PROTESTA E OPOZITES, SOT RRETHOHET KRYEMINISTRIA

PD-LSI mbledhin sot mijëra në rrugë: Qeveri transitore për zgjedhje të lira. Nuk do të ketë fjalime politike. Kryemadhi: Rama nuk i ka bërë mirë llogaritë



(Në foto) Një nga protestat e Partisë Demokratike

Në faqen 2-3

MAXHORANCA

Policia: Do ketë dhunë në protestë. Rama mbledh "të vetët" në Vlorë

Në faqen 4-5

NGJARJA NE '97

Vranë Naim Zyberin, gjykata liron "Gert Gjeneralin": Sjellje shembullore në qeli

Në faqen 6

FONDI I ALUIZNI-T

Lista e tretë, emrat e pronarëve që ndajnë 5 mln euro kompensim

Në faqen 9-10

BERISHA: QESHARAKE

Policia në shtëpitë gjyqtareve të dosjes "Dajti": Gjetëm 17 mijë euro

Në faqen 7

MESAZHI I FORTE I SHBA



"Bomba" e Trumpit për Vuçiq: Njohja e Kosovës, bazë për marrëdhënie të mira

Në faqen 20



Rrëfimi i modeles Alesia Bami: Ja e vërteta e punës së re

Nora Istrefi shtatzënë? Detaji që "e tradhton"

Mashtruesi vjedh Rita Orën. Ku e festuan VIP-at Shën Valentinin

Ajo shfaqet gjithmonë në çdo dalje të sajën në superformë dhe shumë provokuese. Por mesa duket dita e Shën Valentinit ka qenë një nga 'ditët e rrëfimit' për këngëtaresh shqiptare. Në postimin e saj të fundit ajo shfaqet me një fustan mjaft sensual, por që në profil i duket



mjaft mirë barku i rrumbullakosur, i cili nuk ka se si të mendohet se ka qenë thjesht një fryrje e momentit. Duke qenë se Nora Istrefi shfaqet gjithmonë e kuruar deri në detaj dhe e shumë elegante e pa pikë fryrje në stomak, një foto e tillë me një fryrje ...

Suplement

PROTESTA OPOZITA

Zbardhen detajet, pikat e grumbullimit në Tiranë, qytetarët në shesh pa afat

Protesta e opozitës, protestuesit sot rrethojnë Kryeministrinë

Përgatitjet e fundit, baza presion për rezistencë

Valentina Madani

Opozita e bashkuar pritet të nisë sot para Kryeministrisë një protestë pa afat për largimin e qeverisë "Rama". Pritet një pjesëmarrje masive, por edhe rezistencë, çka lë të kuptohet se protestuesit parashikohet të qëndrojnë gjatë në shesh. Protestuesit do të rrethojnë godinën e Kryeministrisë me thirrjet kundër kryeministrit Edi Rama. Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha, kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi, drejtues dhe funksionarët e tjerë të opozitës do të jenë në shesh mes protestuesve, por vetëm në rolin e dëgjuesve. Ndryshe nga protestat e tjera të opozitës, protagonizmin do ta kenë qytetarët, pasi është parashikuar që vetëm ata të flasin në një podium modest para Kryeministrisë.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dhe me banorët e Unazës së Re

PD, Vokshi: Rama e drejton vendin me trafikantë dhe përdhunues

Kryetarja e Lidhjes Demokratike të Gruas Shqiptare, njëkohësisht deputete e PD-së, Albana Vokshi, takoi dje gratë dhe vajzat në veri të vendit. Ajo akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka vënë në krye të shtetit trafikantë dhe përdhunues. "Dhe këtë model e përçon kudo. Në Kavajë, kë vuri? Elvis Rroshin. Ju e dini se kë ka kryetarë në disa bashki të vendit, trafikantë ose përdhunues. Sepse ju e dini se kë ka futur brenda në Parlament. Prandaj kemi rastin të reagojmë", tha Vokshi nga Kukësi. Duke e cilësuar si strategji të Edi Ramës për të lënë në prapambetje shqiptarët, duke



u mbyllur shkollat, mbyllur bizneset, lënie pa ndihmë ekonomike, Vokshi theksoi se këto janë manovra të një njeriu që planifikon t'i blejë në fund shqiptarët në zgjedhjet e ardhshme. "Këtë Edi Rama e ka bërë sepse do që t'i lërë në varfëri të tejskajshme që kur të vijnë zgjedhjet ajo familja

drejtohen para Kryeministrisë. Një pikë tjetër do të jetë Rruga e Kavajës, pikërisht kryqëzimi i "21 Dhjetorit" dhe "Zogu i Zi". Ata do të marshojnë drejt sheshit "Skënderbej", për t'u bashkuar me pjesën tjetër të protestuesve. Në shesh është parashikuar të mblihen protestues të njësisë 8, 9 dhe ata që do të vijnë nga

Babrruja dhe Paskuqani. Pas bashkimit në sheshin "Skënderbej", të gjithë do të nisen drejt Kryeministrisë. Pika tjetër e takimit për njësinë 3 dhe 4 do të jetë kryqëzimi i Rrugës së Elbasanit. Burimet kanë konfirmuar se protestuesit gjatë gjithë marshimit do të shoqërohen nga deputetët e zonave. Ndërkaq, kreu i PD-së, Lul-

zim Basha, do të dalë nga selia e partisë për t'u bashkuar protestuesve i shoqëruar nga disa të rinj. Lulzim Basha ka vendosur të mos mbajë fjalim para protestuesve. Ajo që nuk dihet apo nuk thuhet ende mbetet orari i përfundimit të protestës. Burimet shprehën se nga baza e partisë ka një kërkesë për rezistencë dhe për vazh-

NDRYSHIMI

Kryetari i PD-së Lulzim Basha, kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi, drejtuesit e tjerë të opozitës do të jenë sot në shesh mes protestuesve, por vetëm në rolin e dëgjuesve. Ndryshe nga protestat e tjera të opozitës, protagonizmin do ta kenë qytetarët, pasi është parashikuar që vetëm ata të flasin në një podium modest para Kryeministrisë.



Një nga protestat e opozitës

Tabaku: Zgjidhje politike, asnjë hetim për hajdutët e zgjedhjeve

Deputeti demokrat, Jorida Tabaku deklaroi dje në emisionin "Top Talk" se, "çdo përfaqësues i institucioneve ndërkombëtare e ka kuptuar se zgjedhje të lira e të ndershme, me këtë mënyrë se si ka funksionuar deri tani, nuk mund të ketë. Ne kemi kërkuar që prokuroria t'i hetojë ata që kanë vjedhur zgjedhjet, por nëse vazhdon vjedhja me grupe kriminale dhe askush nuk del para përgjegjësisë, besoj që të gjithë bien dakord që kërkohej një zgjidhje politike", u shpreh Tabaku. Kur u pyet nëse kjo protestë e 16 shkurtit ka mbështetje nga ndërkombëtarët, Tabaku u përgjigj: "Përgjimet i ka nxjerrë 'Zëri i Amerikës' dhe nuk ka kampion më të fortë alarmi për qeverinë sa kur ai që solli ndryshimin në vitin '90, nis e kërkon ndryshim përsëri në vitin 2019".

Shehaj: Protestat largojnë politikanët e korruptuar

Deputeti i PD-së, Agron Shehaj, ftoi dje shqiptarët në protestë, pasi sipas tij, e keqja mund të ndalet vetëm duke protestuar. "Të dashur bashkatdhetarë. Të ngresh zërin, të protestosh për të drejtat dhe dinjitetin njerëzor, është i vetmi mjet për të ndryshuar gjërat. Shqipëria bëhet vetëm duke u treguar pushtetarëve se qytetarët kanë pushtetin dhe qeveritarët janë në shërbim të tyre", - shkruan Shehaj. Ai shton nëse nuk ngrihem, e keqja do të na varfërojë në shumë. "Duke protestuar ndalim të keqen dhe largojmë politikanët e korruptuar. Vetëm duke ngritur zërin do ndalim hajdutët e kriminelët që në politikë dhe në rrugë. Nëse duam që Shqipëria të bëhet, që të rriten punësimi e mirëqenia, që të kthehet rendi e siguria, të ndalet braktisja e vendit, duhet të ngrem zërin e të protestojmë masivisht. Unë nesër do protestoj. Ju pres të gjithëve në shesh!", shprehet z.Shehaj.

dimësi të saj. Por nëse do të vijojë, ende nuk është për-caktuar mënyra sesi do të operohet. Lulzim Basha në rrjetet sociale dha mesazhin e radhës, duke i ftuar shqiptarët në protestën kundër qeverisë. Para këtij mesazhi, Basha priti në zyrën e tij kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi,

ku janë diskutuar detajet e fundit të protestës. Ndërkohë, policia dhe prokuroria janë në gatishmëri. Rreth 1300 policë janë angazhuar për mbarëvajtjen e protestës, ku pjesa më e madhe do vendosen para Kryeministrisë, një pjesë tjetër në anën e Piramidës, ndërsa do të bllokohet çdo lëvizje në rrugën "Ismail Qemali".

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ltaqa Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 e-mail:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotransportit, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Kreu i PD: Përgjegjësia për çdo pengesë ndaj protestës do të bjerë mbi kryehajdutin

Protesta, Basha: Rama para drejtësisë, ose t'i bashkohet Gruevskit

"Do ikin të gjithë pushtetarët e korrumpuar"

Valentina Madani

Një ditë para protestës së opozitës së bashkuar, kreu demokrat Lulzim Basha dha dje mesazhin e fortë se kush guxon të pengojë protestën e shqiptarëve para kryeministrit do të mbajë përgjegjësi. Përmes një postimi në rrjetet sociale z.Basha u bëri thirrje shqiptarëve të vijnë të bashkuar dhe të vendosur në protestën e sotme në Tiranë. 16 shkurti, shkruan kreu i demokratëve, është dita kur një popull që është vjedhur, është tradhtuar, është poshtëruar nga një klikë që e varfëron përditë, ngrihet të marre në dorë fatet e tij si çdo popull evropian. "16 shkurti është dita kur një popull që është vjedhur, është tradhtuar, është poshtëruar nga një klikë që e varfëron përditë, ngrihet të marrë në dorë fatet e tij si çdo popull evropian. Në Europë ku duam të shkojmë, kur qeveria kapet duke vjedhur, ndëshkohet qeveria, ikin hajdutët në burg! Nuk vuan populli!", shprehet z.Basha. Kreu i opozitës një paralajmërim kishte dhe për kryeministrin. "Përgjegjësia për çdo pengesë që i bëhet të drejtës së shqiptarëve për të protestuar kundër pushtetit të vjedhur me votat e krimin do të bjerë e gjitha mbi këtë qeveri hajdute dhe kryehajdutin e saj! Sovrani në Republikën e Shqipërisë është populli shqiptar!", -u shpreh z.Basha. Para këtij mesazhi, Basha priti në zyrën e tij kryetarit e Lëvizjes Socialiste për Integritet, Monika Kryemadhi, ku janë diskutuar detajet e fundit të protestës. Më pas Kryetari i PD-së, Lulzim Basha zhvilloi një takim me një grup studentësh të Inxhinierisë së Ndërtimit. Ai i ftoi që nesër t'i bashkohen protestës së opozitës, ndërsa për Edi Ramën, tha se ka vetëm dy rrugë, ose përpara drejtësisë ose në azil duke iu bashkuar Gruevskit, ish-kryeministrit të Maqedonisë. Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama se i ka shpërfillur studentet. I shpërfilli, sepse mënyra më e mirë sipas tij për ta mbajtur një popull është për ta mbajtur në inorancë dhe nuk ka njerëz që Edi Rama të ketë me shumë frikë se rinia e shkolluar, se studentët shqiptarë. Studentët po përgatiten në kafe, pasi nuk kanë hapësira dhe bibliotekë. Dita e nesërme (sot) është dita e stu-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

THIRRJA
"Nesër (sot) fatin tuaj nuk e ka më në dorë një bandë që ka ardhur me votat e krimin, nuk do ta kenë në dorë ministrat hajdutë, ministrat injorantë dhe të korrumpuar. Të jemi bashkë në pjesëmarrjen më të madhe popullore dhe qytetare", - deklaroi z.Basha.

Kryetaria e LSI flet për bllokimin e autostradës

Protesta, Kryemadhi: Rama nuk ka bërë llogaritë, Tirana në shesh

Kryetaria e LSI-së, Monika Kryemadhi, takoi dje strukturat e partisë në Laprakë. Kryemadhi në fjalën e saj u shpreh se sot në shesh do të jenë dhe shumë socialistë, pasi janë të punë dhe të zhgënjyer me këtë qeveri. Sipas saj, Rama ka frikë nga humbja e pushtetit në PS dhe në qeveri, por koha e tij ka mbaruar. "E keni parë si e ka rrethuar veprën e tij artistike si të ishte në diskotekë? Sikur të kujdesej për shqiptarët aq sa është kujdesur për dekorin e kryeministrit do të ishim shumë të lumtur. Më shumë i dhimbset neoni se sa shqiptarët, ministrot, të rinjtë. Ai njeri ka ikur që dje, por ikja e tij nuk mund të mbajë peng të ardhmen e shqiptarëve. Shqipëria është shtëpia e



shqiptarëve. Për Ramën mund të jetë kolibe qensh, por ne këtu do të ndërtojmë të ardhmen tonë, vend më të bukur nuk ka", -u shpreh Kryemadhi. Po ashtu ajo komentoi dhe bllokimin e autostradës, në të cilët do të ketë punime gjatë ditës së sotme, duke thënë se qytetarët nuk i ndal askush. "Frika për protestën e nesërme i

ka bërë që të bllokojnë rrugën, që të kërcënojnë shoferët e autobusëve, por nuk kanë bërë një llogaritë të vogël se e gjithë Tirana do të vërshojnë në shesh. E gjithë Tirana do të protestojë, pasi do t'i tregojë Ramës që është i vetëm. Nesër (sot) në shesh janë të gjithë qytetarët dhe jo politika", u shpreh kryetaria e LSI.

dentëve në radhë të parë. Ai i shpërfilli kërkesat tuaja. Rama ka shumë frikë rininë e shkolluar. Nesër (sot), shqiptarët e bashkuar si asnjëherë në 30 vite do të marrin faktin e tyre në dorë. Nesër (sot) Rama para drejtësisë ose t'i bashkohet Gruevskit në azil", tha Basha. Edhe nga Unaza e Re ku takoi protestuesit, kreu i PD-së ironizoi kryeministrin Edi Rama se po ia mbannë nga protesta e opozitës. "Shtëpitë e tyre nuk arrihi t'i prishë antiligji, oligarkët hajdutë nuk gjejnë vrimë miu ku të futen dhe Edi

Rama, arroganti, fjalëpisti, kryehajduti po bëhet gati t'ia mbathë, nesër (sot) në Vlorë, pasnesër në azil. Ky është shembulli konkret i forcës që keni në duar bashkëqytetarët e mi, kurrë nuk mund ta ketë fatin tuaj në dorë asnjë qeveritar, fatin tuaj e keni në dorë ju, e bëni ju, deklaroi z.Basha. Përkrah banorëve të Astirit, simbol i rezistencës 105 ditore në mbrojtje të banesave tyre, Basha tha se e keqja ka zaptuar çdo pjesë të këtij vendi. "E keqja nuk është varfëria, varfëria është pasojë e të keqes, e keqja është qeveria

që është kapur duke vjedhur taksat tuaja, buxhetin tuaj, pasuritë tuaja, është kapur siç tregon Zëri i Amerikës' duke vjedhur pushtetin në bashkëpunim me krimin e organizuar, është kapur duke vjedhur votat tuaja, vullnetin tuaj. Kjo e keqja kudo në Europë do ta kishte marrë një përgjigje përmes votës së lirë ose përmes drejtësisë që funksionon. Këto dy shtylla përkohësisht kanë rënë. Me 16 shkurt para Kryeministrit në orën 11 ju keni në dorë të diktoni çdo ndryshim", deklaroi kreu i PD-së.

Berisha: Rama urdhër policisë, po kontrollojnë në hotele

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje se kryeministri Edi Rama ka dhënë urdhër që të kontrollohen të gjithë kosovarët që janë akomoduar në hotele në vend. Sipas mesazhit që publikoi Berisha thuhet se policia po bën reprezalje hotele për të marrë identitetin e klientëve Kosovë. "Shfazonet i tmerruar Rama nga Kosovarofobia!", shprehet ish-kryeministri. Berisha zbardhi mesazhin e qytetarit dixhital: "Me urdhër të Ramës ka shkruar policia në gjithë hotelet e Tiranës, Durrësit dhe Vlorës dhe u ka kërkuar që t'i japin info për të gjithë kosovarët që do jenë në hotel. Policia u bën reprezalje hoteleve për t'u marr identitetin e klientëve kosovar". Z.Berisha shkruan: "Aalbanofobi Edvin Kristaq Mbatsharaku është i tmerruar edhe nga mijëra shqiptarë që kanë hyrë 24 orët e fundit në Shqipëri nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi Presheva, Milano, Vjena, Hamburgu, Londra, Parisi. Duke dënuar qendrimit e tij prej mbatsharaku të lemeritur, përshëndes vëllazërisht të gjithë ata shqiptarë që kanë ardhur dhe po vijnë për të dëshmuar dhe firmosur fundin e Kakistokracisë në Shqipëri".



Mediu, thirrje shqiptarëve: Ejani ta bëjmë Shqipërinë evropiane!

Kreu i PR-së, Fatmir Mediu, i bëri thirrje shqiptarëve që të jenë në protestën e nesërme, e të marrin fatin në dorë. Sipas tij me praninë e tyre qytetarët do të tregojnë që Shqipëria evropiane nuk është një ëndërr e vdekur. "Shqiptarët duhet të ngrihen për të treguar se Shqipëria evropiane nuk është një ëndërr e vdekur, por një realitet ku çdo shqiptar nuk i fal lirinë dhe të drejtat e tij, nuk ul kokën përballë varfërisë, lumturinë e ndërton me autoritetin dhe dinjitetin që i ka fal Zoti. Nuk mund të pranojë përbuzjen, fyerjen e Ramës, nuk mund të pranojë të lërë Shqipërinë, por lufton për Shqipërinë dhe kombin shqiptar evropian. Këtë rrugëtim të shqiptarëve evropianë nuk e ndal dot Rama, antimitingjet e turpshme si komunistët në 1990-1991, nuk e ndalin as pushteti që bllokon rrugët e lirisë dhe të drejtës, apo policë që nuk i shërbejnë ligjit, por pushtetit", shprehet Mediu.

**POLICIA
MASAT**

Policia dhe PD u përplasën për protestën. Demokratët: Nuk kemi nxitur dhunë

Policia: Do ketë dhunë në protestë. PD: Kriminelët janë në PS

"Kriminelët nuk janë mes protestuesve, por në qeveri"

Policia dhe opozita janë përplasur sërish dhe jo vetëm për shkak të mosprovimit të zhvillimit të protestës edhe në rrugë e sheshe të tjera, veçse bulevardit "Dëshmorët e Kombit", por edhe për pretendimet e uniformave blu se gjatë këtij tubimi ka rrezik për akte dhune. Nëpërmjet një deklarate zyrtare të shpërndarë gjatë ditës së djeshme, Policia e Rëndit ka bërë të ditur se nuk mund të plotësojë të gjitha kërkesat e opozitës për të mitingje edhe akse të tjera rrugore të Tiranës, ndërsa edhe një herë paralajmëroi se persona me rekorde kriminale ose të dënuar më parë për krime të rënda janë përgatitur për të ushtruar dhunë në protestë. Ndërkohë që në një dalje të posaçme menjëherë pas kësaj deklarate ka reaguar Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi.



Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi

POLICIA
"Policia e Shtetit ka administruar edhe informacione se persona të caktuar, me rekorde kriminale apo të dënuar më parë për vepra të rënda penale, janë përgatitur për të ushtruar dhunë në protestën e datës 16 shkurt 2019, të organizuar nga Partia Demokratike".

Balla: Protesta e sotme s'është e popullit, por e Lulit dhe Monikës

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla se protesta e sotme nuk është e qytetarët, por për hallin e lidhshpirt të opozitës. I ftuar në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në "News 24", Balla u shpreh se Basha është në hall pasi ka një parti shumë të dobët në prag të zgjedhjeve vendore, ndaj dhe kërkon që nëpërmjet protestës të fitoi pushtet në tryezë. "Të flasësh në emër të popullit është diçka shumë e madhe, tani flasin ata që nuk e kanë shumicën e shqiptarëve më vete. 17 muaj më parë shqiptarët votuan që opozita të jetë pakicë. Për t'u votuar duhen pritur zgjedhjet. Por në të gjithë e kuptojmë që opozita është sot në hall të madh. Hallexhju



më i madh është Basha, se drejton një parti që ka degraduar, parti që s'ka bërë asnjë përpjekje të riorganizojë strukturat. Për sa kohë që janë zhytur në një vorbull pa lidhshpirt, se demokratët mendojnë që Lulzim Basha nuk mund t'i sjellë në pushtet", - tha Balla.

la. Ndaj theksoi ai kjo nuk është protesta e popullit, por e lidhshpirtit të opozitës. "Ne do të dimë t'i lexojmë protestat, i kemi lexuar kur protestën e bën populli. Nesër nuk është protestë e qytetarëve është e Monikës dhe e Lulit", - u shpreh Balla.

sa të jetë e mundur mjediset, ku ajo do të zhvillohet", - deklaroi policia. Më tej, ajo sqaronte se kishte refuzuar disa kërkesa të opozitës për ta shtrirë protestën edhe në rrugë të tjera. "Policia e Shtetit është përballur edhe me disa kërkesa të pamundura të Partisë Demokratike, ku njoftohet synimi për të bllokuar rrugë apo mjediset

të caktuara, që janë me rëndësi të veçantë për funksionimin normal të jetës publike në kryeqytet, si dhe për veprimtarinë e pacenuar të disa misionëve të huaja diplomatike", - thuhet në deklaratë. PD

Menjëherë pas kësaj deklarate nga selia blu, Gazmend Bardhi hodhi

poshtë pretendimet e policisë, duke deklaruar se në protestën e opozitës nuk ka kriminelë. "Partia Demokratike nuk ka nxitur kurrë dhunë dhe as nuk ka pasur në radhë e saj njerëz të krimi! Persona me rekorde të rënda kriminale nuk janë mes nesh, nuk janë mes protestuesve, por janë në qeveri dhe me qeverinë", tha Bar-



Tirana në shtetrrëthim, policia 1300 forca për protestën

Tirana do jetë sot në gjendje "shtetrrëthimi". Rreth 1300 forca policie jo vetëm nga komisaritet dhe forcat e specializuara që gjenden në Tiranë, por edhe forca policoe nga rretho do të kujdesen për mbarëvajtjen e protestës. Rreth 900 punonjës rendi do të dislokohen pranë kryeministrisë. Vëmendje e veçantë do i kushtohet ruajtjes së institucioneve që janë pranë bulevardit "Dëshmorët e Kombit". Në gatishmëri do të qëndrojnë ambulanca dhe shërbimi zjarrfikës. Parapërgatitja për protestën ka nisur më herët. Rreth një javë më parë me një udhëzim të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë u është lënë detyrë komisariteve të evidentojnë personat e dhunshëm. Ata do të monitorohen gjatë protestës. Kontrolle do të kryhen në akse të ndryshme të Tiranës për njerëz të dyshimtë, ose për ata që ka informacion. Ndryshe nga protestat e mëparshme, priten të aktivizohen më pak punonjëse policie femra. Masa ka marrë edhe Policia Rrugore. Autobuset që do të vijnë me protestues nuk do të lejohen të futen në qytet. Ata që vijnë nga ana veriore do stacionohen pranë stadiumit "Asllan Rusi", ndërsa nga ana jugore të Fakulteti Ekonomik.

Policia kriminale në Kuvend, merr mostrat e bojës së përdorur nga Paloka

Incidenti i ndodhur në seancën e së enjtes, ku nënkryetari demokrat i Kuvendit, Edi Paloka zbrazti një shiringë me bojë në drejtim të kryeministrit, Edi Rama, nuk ka kaluar edhe pa pjesën komike. Nuk bëhet fjalë për humorin e krijuar në rrjetet sociale, por përfshirjen e organeve ligjbatuese për hetimin e këtij incidenti. Dje janë shpërndarë pamjet e zbarkimit në sallën e Kuvendit të Policisë Kriminale, ku ekspertët e saj kanë marrë mostrën e bojës së përdorur nga Paloka. Kjo, pasi siç bëri të ditur dy ditë më parë policia dhe Garda e Republikës ata dyshojnë se boja e përdorur nga Paloka ishte një substancë kimike i parapërgatitur prej tij, me qëllim për të dëmtuar kryeministrin.

dhi. Duke iu kundërpërgjigjur deklaratave të policisë, PD i kujtoi asaj dhe mazhorancës se kriminelët kanë genë dhe janë pjesë e saj. "Njoftojmë Policinë Politike se as shtetasi Vangjush Dako, as shtetasi Saimir Tahiri, as shtetasi Arben Ndoka, as shtetasi Armando Prenga, as shtetasi Mark Frruku, as shtetasi Artur

Bushi, as shtetasi Artur Bardhi, as shtetasi Elvis Roshi, as shtetasi, Jurgis Cyrbja, as shtetasi Fatmir Xhafaj, nuk do të jenë në protestë. Ndërsa shtetasi Edi Rama dhe Damian Gjikhuri do të jenë në Vlorë, në një antimiting, ku administrata është detyruar forcërisht të marrë pjesë", tha Bardhi.



Rama: S'është miting o mavri me bojë, por dialogu qytetar "Bashkia që duam"

PS, takim sot në Vlorë në "Sheshin e Flamurit", ja çfarë do të ndodhë

Takimi do të nisë 30 minuta para protestës

Gjatë ditës së sotme nuk do të tubohet vetëm në Tiranë, por edhe në Vlorë. Ndërsa në Tiranë do të mbahet protesta e paralajmëruar e opozitës, thuajse në të njëjtën orë mazhoranca do të zhvillojë një takim në Vlorë, ku do të mbledhë mbështetësit e vet. Vetë opozita e ka konsideruar këtë si një antimiting të organizuar nga qeveria për të t'u treguar shqiptarëve forcën e numrave, ndërsa vetë kryeministri Edi Rama hodhi poshtë që ky të ishte një antimiting. Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, ai ndërsa ironizoi opozitën deklaruar të bëra, theksoi se takimi i sotëm i Vlorës është vetëm vijimi i dialogut që ai ka vendosur të zhvillojë me qytetarët në kuadër edhe të taktikës elektorale në funksion të zgjedhjeve të ardhshme vendore. Ai bëri të ditur se do të jetë atje për të takuar qytetarët, në kuadër të turit të dialogut "Bashkia që duam". "Na qenkan shqetësuar andej nga Mavroboja për takimin e Vlorës nesër. Presion i madh për t'i sjellë njerëzit në miting thonë. S'është miting o mavri me bojë, po dialogu qytetar "Bashkia që duam", prandaj mos na bëni reklamë aman të keqen, se i thonë Vlorë hesapi dhe s'kemi ku ulim njerëzit", - shkroi Rama. Ash-tu siç bën të ditur vetë kryeministri në statusin e tij, bëhet fjalë për një takim që ndryshe nga të gjithë takimet e tjera që ka zhvilluar këto ditë në qytete të ndryshme si në Korçë, Lezhë apo Rrëshen, të cilat janë mbajtur në ambiente të mbyllura, sot mazhoranca këtë takim do ta mbajë në një ambient të hapur. Dhe mbi të gjitha, në një shesh simbol për shqiptarët, "Sheshin e Flamurit". Burime nga qeveria kanë bërë të ditur se takimi do të nisë rreth orës 10 e 30 dhe të pranishmit do të qëndrojnë të ulur në karrige, të vendosura në mënyrë rrethore në të gjithë sheshin. Një mënyrë kjo për t'i ulur të pranishmit sipas një plani dhe për të përcjellë mesazhin e shumë pjesëmarrësve.



Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit me pedagogët, dje në Vlorë

TAKIMI

Burime nga qeveria kanë bërë të ditur se takimi do të nisë rreth orës 10 e 30 dhe të pranishmit do të qëndrojnë të ulur në karrige, të vendosura në mënyrë rrethore në të gjithë sheshin. Një mënyrë kjo për t'i ulur të pranishmit sipas një plani dhe për të përcjellë mesazhin e shumë pjesëmarrësve.



Meta në Gjermani, takon homologun armen. Nxitje të bashkëpunimit

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih. Gjatë punimeve të kësaj konference, Meta është takuar edhe me homologun e Armenisë, Armen Sarkissian. Duke iu referuar marrëdhënieve përgjithësisht të mira e lidhjeve të vjetra mes dy popujve, kreu i shtetit nënvizoi rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit midis dy vendeve. Në mënyrë të veçantë, Meta nënvizoi rëndësinë e nxitjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit ekonomik e tregtar. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim lidhur me nevojën e nxitjes së kontakteve mes qytetarëve të të dyja vendeve dhe të bashkëpunimit në fushën e turizmit. Një vëmendje e veçantë i kushtua edhe zhvillimeve në rajonin e Ballkanit dhe të Kaukazit. Ndërkohë, përmes një postimi në "Facebook", Meta thotë se sfidat e shumta të sigurisë mund të tejkalohen përmes vullnetit solid politik dhe aleancave të forta e të qëndrueshme. "Kënaqësi të marr pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih. Sfidat e shumta të sigurisë mund të tejkalohen përmes vullnetit solid politik dhe aleancave të forta e të qëndrueshme. Partneriteti Trans-Atlantik mbetet jetik për rendin ku mbizotërojnë vlerat e demokracisë, lirisë dhe dinjitetit njerëzor", - shkroi Meta.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C

"Trull + ndërtesë" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar per shitje eshte 2.175.096 Loke.

Data e shpalljes 22.01.2019
 Data e zhvillimit 21.02.2019 deri ne oren 16.⁰⁰
 Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

RAMA NË VLORË, VASILI: ANTIMITING TË MBARË, TË RROSH E TA KUJTOSH

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, përmes një statusi në "Facebook" ka ironizuar vendimin e mazhorancës, që thuajse në të njëjtën orë me protestën e opozitës në Tiranë të zhvillojë një takim të sajën në Vlorë. Sipas tij, ky është një antimiting dhe që tregon se kryeministri i mungojnë idetë. "Antimiting të mbarë Edi Rama, të rrosh e ta kujtosh! Qesharak dhe shumë i lodhur, fantazia e zbrazur e Edi Ramës shkon maksimumi deri tek antimitingu. Fati i zi i atyre që bëjnë antimitingje dihet. Antimiting të mbarë Edi Rama të rrosh e ta kujtosh", shkroi Vasili.

Senida Mesi shpall ambicien për kandidate të Bashkisë së Shkodrës

Ish-zëvendëskryeministria, Senida Mesi e ka lënë të hapur mundësinë për të kandiduar për kryetare të Bashkisë së Shkodrës si përfaqësuese e Partisë Socialiste. E pyetur nga gazetarët dje në Shkodër rreth kësaj çështjeje, ajo ka deklaruar se ky do të ishte një privilegj për këdo, ashtu edhe për atë. "Jemi në një proces të brendshëm të Partisë Socialiste. PS dhe Shkodra ka kandidatë potencialë shumë të mirë, edhe më të mirë se unë. Sigurisht për çdo individ, edhe për mua përfshirë, do të ishte e vlerësuar dhe e respektuar, nëse jo vetëm PS, por edhe qytetarët e Shkodrës do të donin apo do dëshironin që unë të isha një kan-



didaturë, se në fund të fundit unë jam bijë e këtij qyteti", - tha Mesi. Ndërsa ajo ka kërkuar që t'i lihet kohë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, ka përforcuar edhe një herë se do të ishte nder edhe për të që të ishte kandidatë e PS për këtë bashki. "Është një vlerësim për çdo individ dhe këtu bëj pjesë edhe unë, por është një proces

që nuk është finalizuar. Unë do bëj fushatën për këdo që PS të vendosë, pasi jam shumë e bindur që në Shkodër ka ardhur momenti për t'u ndryshuar dhe për të bërë rotacionin e pushtetit", - shtoi Mesi. Ndërkohë që gjatë ditës së djeshme në funksion edhe të përgatitjeve për zgjedhjet vendore, PS e Shkodrës ka zgjedhur edhe kryetarin e ri të saj. Kështu, Arvid Osja nuk do të jetë më kryetar në detyrë i PS Shkodër, pasi strukturat drejtuese në Tiranë e kanë pranuar dorëheqjen e tij të paraqitur kohë më parë dhe në vend të tij tashmë është zgjedhur kryetari i ri i PS Shkodër, icili është Edmond Emini.

Dritan Leli, drejtuesi politik i Qarkut Vlorë, Damian Gjokuri si dhe deputetë të tjerë kësaj zone. Ndërkohë që në Tiranë thuajse të gjitha institucionet qendrore do jenë pushim dhe në mbikëqyrjen e forcave të policisë dhe Gardës së Republikës. Gjatë pasdites së djeshme godina e Kryeministrit së pjesën e pasme në lulishten që e lidh atë me zyrtarë i INSTAT-it

janë vendosur disa rrjeta për të penguar protestuesit nga anë. Gjithashtu, në pjesën përpara Kryeministrit është mbuluar si në çdo tubim tjetër i opozitës edhe neoni zbulurues në hyrje të godinës është mbuluar me një skelë hekuri dhe rrjeta plastike për ta mbrojtur atë nga dëmtimet. Ndërkohë që edhe vetë kryeministri po qëndron që prej ditës së djeshme në

Vlorë. Ai zhvilloi një takim në kuadër të Paktit për Universitetin, me pedagogë e student të Universitetit të Vlorës. Gjatë këtij takimi, ai nuk nguroi të sulmonte pedagogët e Universitetit të Tiranës që janë organizuar gjithashtu në një protestë. Sipas tij, kjo vjen se ata nuk duan që të përshihen në vetingun e diplomave dhe punës që bëjnë.

Ngjarja e 6 gushtit 1997, ja si u vra në Milano rivali i Gaz Muçës

Ekzekutoi të "fortin" e Tiranës, Naim Zyberin, lirohet i dënuari me burg përjetë, Gert Gjinarari

Vendimi i gjykatës: Sjellje shembullore në burg e marrëdhënie të rregulluara me trashëgimtarët e viktimës

KORÇË

Gjykata e Shkallës së Parë në Korçë ka vendosur lirimin me kusht nga burgu të njërit prej të akuzuarve për vrasjen e Naim Zyberit, i njohur si i "forti" i Tiranës. Bëhet fjalë për Gert Gjinararin, një emër i njohur për drejtësinë, i cili ishte dënuar me burgim të përjetshëm për ngjarjen e rëndë të ndodhur në vitin 1997, në Milano të Italisë. Vendimi u dha ditën e enjte nga gjyqtari Markelian Kuço, duke i siguruar Gjinararit lirinë pas më shumë se 19 vitesh burgim. Në vendimin e gjykatës së qytetit juglindor, trupa gjykoese ka arritur në përfundimin se Gert Gjinarari i plotëson të gjitha kushtet për lirim me kusht për pjesën tjetër të mbetur të dënimit, që nga sjellja shembullore, projektet e paraqitura për të ardhmen, fakti që është i gatshëm të riintegrohet, marrëdhëniet e mira me trashëgimtarët e viktimave e me radhë. 45-vjeçari Gert Gjinarari ka përfituar lirim me kusht me të njëjtën procedurë abuzive që shpëtoi nga dënimi përjetë edhe Dritan Dajtin, autor i vrasjes së katër policëve. Ai u dënua me burgim të përjetshëm në Itali, por me sjelljen e dosjes në Shqipëri ai kërkoi gjykim të shkurtuar, duke pranuar të gjitha aktet e akuzës, çka e çoi dënimin përjetë në 25 vite burg. Një procedurë kjo e ndryshuar vitet e fundit, ku tashmë ndalohej gjykimi i shkurtuar për vepra të rënda penale, veçanërisht për vendime me burgim të përjetshëm. Në vendimin që ka siguruar "Gazeta Shqiptare" thuhet se "urdhërohet i dënuar Gert Gjinarari që gjatë kohës së provës të raportojë rregullisht para Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Tiranë, sipas rregullave që inicohen për këtë qëllim procesi nga ky shërbim ligjor, si dhe të marrë në çdo rast lejen e këtij shërbimi për lëvizjet e shpeshta brenda ose jashtë vendit, së bashku me detyrimin për të informuar Shërbimin e Provës për çdo ndryshim të mundshëm të vendit të banimit që duhet të realizohet vetëm mbijelimin e këtij shërbimi". Gjithashtu, në vendim theksohet që Gjinarari gjatë kohës së provës nuk duhet të shoqërohet me persona të dënuar, dhe as mos të mbajë me vete asnjë lloj arme. Gert Gjinarari u arrestua në Itali me akuzën për vrasjen e Naim Zyberit në një spital në Milano, vrasje e kryer së bashku me mikun e tij Arben Grori. Ai u ekstradua në Shqipëri në vitin 2014, pas vendimit që gjykata italiane mori për dënimin e tij me burg përjetë. Por 45-vjeçari duke shfrytëzuar gjykatat shqiptare ka kërkuar të hetohet në gjendjen që është dosja, duke përfituar uljen



Gert Gjinarari dhe Viktima Naim Zyberi

dënimin në 25 vjet. Nuk kaluan më shumë se vetëm 5 vite nga ekstradimi, kur i akuzuari për vrasjen e bujshme kërkoi nga gjykata e Korçës lirimin me kusht nga burgun i sigurisë së lartë të Drenovës.

VRASJA E NAIM ZYBERIT
Në fillim të viteve '90, Naim Zyberi njihej si një nga të fortët e kryeqytetit, rival i fortë i një tjetër emri të njohur në Tiranë gjatë atyre viteve, Gaz Muça. Zyberi u ekzekutua më 6 gusht të vitit 1997 nga tre persona, dy prej të cilëve Arben Grori dhe Gert Gjinarari. Naim Zyberi në vitet e para të '90-s kishte arritur të mblidhte rreth vetes një grup djemsh, të cilët, sipas mënyrës që kishin vetëpërcaktuar, bënin ligjin në lagjet e kryeqytetit. Ai u cilësua si një nga atentatorët e Gaz Muçës, ngjarje për të cilën edhe u arrestua bashkë me Franc Konomin, i cili nuk u mor vesh asnjëherë se si arriti jo vetëm të dilte nga burgu, por edhe t'i shpëronte deri në vitin 2010 hakmarrjes së djemve të Rrugës Bardhyl. Pas hapjes së burgjeve në '97-n, edhe Naim Zyberi si shumë të tjerë arritën të largoheshin nga qelëti duke rifituar lirinë. Por Zyberi nuk do t'i shpëronte dot hakmarrjes për vrasjet e Artur Grorit dhe të Gaz Muçës. Ai u ndoq deri në Itali nga vëllai i Grorit, Arbeni dhe atentati i parë u bë në një bar në Torino, vend ku Naim Zyberi mbeti i plagosur rëndë dhe për këtë arsye, iu dësh të qëndronte i shtuar në spital për disa kohë. Madje, për mjekim më të specializuar u dërgua në spitalin e Milanos. Fakti që Zyberi mbeti gjallë nuk bëri që autorët të dorëzohen. Më datë 6 gusht, Gert Gjinarari, që mbante një tufe me lule në dorë, brenda të cilës kishte fshehur pistoletën dhe Arben Grori, bashkë me një person tjetër, futën në dhomën e spitalit ku ndodhej Zyberi dhe e qëllojnë aty për vdekje. Por shumë shpejt arrestohen nga policia italiane.



Faksimile e vendimit të gjykatës së Korçës

SHKURT

Vrau bashkëshortin, lihet në burg gardisti TIRANË - Gjykata për Krimet e Rënda dje vendosi lenien në burg të gardistit Alket Arapaj, i cili katër ditë më parë vrau me armën e shërbimit gruan e tij 36-vjeçare, Ervilma Seferaj. Ngjarja e rëndë, e cila tronditi banorët e kryeqytetit ndodhi në banesën e çiftit, në Allias, 44-vjeçari është shfaqur i penduar në gjykatë, ndërsa duke sikur kërkonte të fshihej poshtë xhupit të tyre, i mbërthyer deri në gjyq dhe i struktur në kafazin e xhamit përkrah një punonjësi të policisë. Seanca gjyqësore ndaj tij është zhvilluar me dyer të mbyllura, me kërkesë të prokurorit Besnik Muçi. Pasi ka dëgjuar palët, gjykatësi ka vendosur të lërë në qeli 44-vjeçarin, i cili ka kërkuar që institucionet shtetërore të kujdesen për vajzën 3 vjeçe, e mbetur pa nënë dhe me të atin në burg. Shkak për vrasjen dyshohet xhelozia, pasi Arapaj ka deklaruar se kishte dyshime se e shoqja takohet me persona të tjerë kur ai ishte në punë. Edhe gjatë marrjes në pyetje Arapaj është shfaqur i paqëndrueshëm psikologjikisht.

U kapën me 1 ton drogë në Kapshticë, 4 në pranga KORÇË - Policia e Korçës ka bërë të mundur arrestimin e katër personave, të cilët dyshohen si të përfshirë në veprimtarinë e paligjshme të shitjes dhe transportit të lëndëve narkotike. Droga u gjet e fshehur në dy kamionë dhe për këtë u arrestuan dy shoferët dhe dy bashkëpunëtorët e tjerë. Ky arrestim vjen dy ditë pas bllokimit të lëndës narkotike në Kapshticë, e cila ishte fshehur mes krundeve dhe trafikantit kishin si qëllim transportimin e saj drejt shteti të Greqisë. "Në vijim të informacionit, për goditjen e një tentative ndërkombëtare të trafikut të lëndëve narkotike, specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë arrestuan në flagrancë 4 shtetas: A.S, 47 vjeç; Z.H, 56 vjeç; A.M, 50 vjeç; M.S, 30 vjeç. Në dalje të Republikës së Shqipërisë u paraqitën 2 mjete, tip kamion. Gjatë kontrollit të imëtishëm si edhe skanimit të mjeteve, u gjet dhe sekuestrua një sasi 1074,2 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis. Nga kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore, u arrestuan drejtuesit e mjeteve dhe dy bashkëpunëtorët të dyshuar të tyre, si të implikuar. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan disa mjete, sasi monetare dhe telefona. Materialet i kaluan për ndjekje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda Tiranë", thuhet në njoftim.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019 .

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING"
The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**.
Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

17 mijë euro e fishekë, Damini: Paratë janë të djalit, kam dokumente

TIRANË

Me vendim të Gjykatës së Krimeve të Rënda, policia ka ushtruar kontroll në pesë banesat e tre gjyqtarëve të Apelit, të cilët disa ditë më parë pranuan gjykimin e shkurtuar për Dritan Dajtin, duke e shpëtuar atë nga burgimi i përjetshëm. Kërkesa për kontrollin e banesave është bërë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cila po heton gjyqtarët për akuzën e korrupsionit. Kjo pas vendimit të dhënë prej tyre, i cili çoi dënimin me 25 vite burg për Dajtin, i akuzuar për vrasjen e 4 policëve në gusht të vitit 2009. Mësohet se kontrollin e uniformave blu kanë nisur mëngjesin e djeshëm, në orën 07:00. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se forcat speciale të policisë zhvilluan kontrolle blic në banesat e gjyqtarëve Skënder Damini, gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Vlorë; Petrit Aliajn, gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Vlorës, si dhe Aleks Nikollin, gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Shkodër. Operacioni është zhvilluar njëkohësisht në 5 qytete dhe konkretisht në Tiranë, Lezhë, Shkodër, Vlorë dhe Sarandë, aty ku ndodhen edhe shtëpitë e gjyqtarëve. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se gjatë kontrolleve të bëra janë gjetur një sasi municion, mijëra euro dhe prova të tjera, të cilat do të administrohen nga organet ligjzbatuese". Gjyqtari Damini u shoqërua në polici dhe më tej u la i lirë pas disa orëve marrëje në pyetje. Në kontrollin blic, forcat speciale gjetën në banesën e tij një sasi municionesh luftarakë pa leje të autoriteteve, si dhe një vlerë monetare prej rreth 17 mijë eurosh të vendosura në sirtar në vendin e rrobave të brendshme. Pas shoqërimit, "GSH" ka zbardhur dëshminë e gjyqtarit Damini, i cili ka deklaruar se paratë janë të djalit të tij biznesmen dhe se për këtë ka dokumente.

KONTROLLET

Forcat speciale të policisë ushtruan kontroll në banesën e gjyqtarit Skënder Damini, në Tiranë dhe banesën e tij në Vlorë, pranë "Ujit të Ftohtë". Gjithashtu, është ushtruar kontroll në banesat e gjyqtarit Petrit Aliaj në Sarandë dhe banesën në Tiranë. Të afërmit e tij janë shprehur se ai nuk gjendet në Sarandë, por është larguar drejt Greqisë. Aksioni është zhvilluar edhe në Lezhë, në banesën e Aleks Nikollit, ndërsa nuk sqarohet nëse janë gjetur materiale komprometuese. Policia e Shtetit ka konfirmuar operacionin e djeshëm për kontrollin e banesave të tre gjyqtarëve që zbutën vendimin për Dritan Dajtin. Policia deklaroi se ka gjetur municione, mijëra euro dhe prova të tjera, pa për-

Shpëtuan Dritan Dajtin nga burgimi i përjetshëm, kontrollohen banesat e gjyqtarëve në 5 qytete

Policia: Gjetëm municione dhe mijëra euro. Shoqërohet e më pas lihet i lirë gjyqtari vlonjat



Gjyqtari Skënder Damini



Dritan Dajti në gjykatë



Kontrollet në banesat e gjyqtarëve të Dajtit, Berisha: Qesharake!

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha i cilëson qesharake kontrollet e forcave speciale të policisë në banesat e gjyqtarëve, që dhanë vendimin për Dritan Dajtin, duke e shpëtuar nga burgimi i përjetshëm. Sipas tij, gjyqtarët zbatuan urdhrat e Ramës për të dhënë atë vendim. "Qesharake! Miq, Rama dy javë pasi i hoqi 4 dënimet me vdekje mikut të tij, vrasësit serial Dritan Dajti dërgoi sot herët në mëngjes forcat speciale për të kontrolluar vrasësit serialë të togave të zeza që zbatuan urdhrat e tij!", shkruan Berisha.

VENDIMI

Pak ditë më parë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda pranoi gjykimin e shkurtuar për Dritan Dajtin, i cili ishte dënuar me burg përjetë, duke e dënuar me 25 vite burg për vrasjen e 4 policëve në gusht të vitit 2009. Procesi ndaj Dajtit zgjati rreth 10 vite, ndërsa në Shkallë të Parë u dënua me burgim të përjetshëm në vitin 2014. Çështja është gjykuar nga gjyqtarë, të cilët vinin nga Apelet e rretheve. Dy gjyqtarët e Shkodrës, Fuat Vjerdha dhe Lindita Hoxha kanë votuar pjesërisht kundër vendimit për gjykimin e shkurtuar. Ndërsa tre gjyqtarët e tjerë, Skënder Damini, Petrit Aliaj dhe Aleks Nikolla kanë pranuar gjykimin e shkurtuar, duke bërë që Dritan Dajti t'i shpëtojë dënimit me burg të përjetshëm.

caktuar se çfarë provash bëhet fjalë. Duke iu përgjigjur interesimit të medias, Policia e Shtetit konfirmon aksionin e ndërmarrë nga forcat speciale, në zbatim të urdhrat nr. 89, datë 14 shkurt 2019, të Gjykatës së Shkallës

së Parë për Krime të Rënda, për të ushtruar kontroll në banesat e tre gjyqtarëve, të cilët zbutën dënimin e Dritan Dajtit. Operacioni policor vazhdon, por mund të konfirmojmë se deri tani janë gjetur një sasi municioni,

mijëra euro dhe prova të tjera, të cilat do të administrohen nga organet ligjzbatuese. Në përfundim të operacionit, Policia e Shtetit do të ketë një komunikim të veçantë me median dhe publikun", thuhej në njoftimin

zyrtar të ditës së djeshme.

DËSHMIA E GJYQTARIT SKËNDER DAMINI

Ka qenë avokati i tij që ka rrëfyer dëshminë e Daminit pas shoqërimit. Mësohet se gjyqtari ka thënë se paratë e gjetura në banesë janë të djalit të tij dhe disponon dhe dokumentacionin e tyre. "Gjyqtari ka firmosur si të ligjshëm kontrollin e banesës, meqenëse ishte me urdhrë gjykatë", tha avoka-

ti i tij. Për sa i përket vendimit për Dritan Dajtin, gjyqtari ka marrë të gjithë përgjegjësinë. "Paratë e gjetura janë të djalit dhe disponoj të gjithë dokumentacionin e tyre. Ndërsa 8 fishekët e gjetur janë të pistoletës që e mbaja deri para pak kohësh sipas ligjit dhe e kam dorëzuar. Lidhur me vendimin për të akuzuarin, ka qenë bindja ime personale nga leximi i dosjes", ka dëshmuar gjyqtari Damini.

THIRRJE

Për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të "Shoqata e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, Golaj".

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme "Shoqata e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, Komunale Golaj".

Nëpërmjet këtij publikimi njoftojmë për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme të Antarve të "Shoqata e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave, Komunale Golaj

Vendi: Golaj
Data :21/02/2019
Ora: 10:00

Rendi i ditës për këtë Mbledhje propozohet:

1. Rizgjedhjen e Kryetarit të Shoqatës, stafit teknik të saj, shtimin dhe pakesimin e anetareve të shoqatës :

Kryetari i Shoqatës
Abdullah NEZA

Aksioni në banesat e gjyqtarëve të Dajtit, Rama: Vrasës të drejtësisë!

TIRANË - Pas aksionit të policisë me kërkesë të Krimeve të Rënda në banesat e tre gjyqtarëve që shpëtuan Dritan Dajtin nga burgimi i përjetshëm, ka reaguari kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Përmes një postimi në rrjetin social, ai shkruan se po u tregojnë vrasësve të drejtësisë për 4 policët e vrarë se, koha e të paprekshmëve po mbaron. "Faleminderit me një përulje të thellë shërbëtorëve të shtetit, që thyen mitin 30-vjeçar të paprekshmërisë absolute të kriminelëve me toga të zeza. Duke u treguar vrasësve të drejtësisë për 4 policët e vrarë se koha e të paprekshmëve po mbaron, shteti sot ka hyrë në një fazë të re", shkruan kryeministri Rama.



STATISTIKAT

Në vitin 2018 paga mesatare u rrit me 2.4% krahasuar me një vit më parë. Paga mesatare në ekonomi në tremujorin e tretë të vitit të kaluar ishte rreth 50 mijë lekë. Institutit të Statistikave bën të ditur se sipas të dhënave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, paga mesatare pësoi një rënie të lehtë me afro 400 lekë në muaj kra-



Në vitin 2018 u rrit me 2.4%, krahasuar me një vit më parë

Paga mesatare, afro 50 mijë lekë

hasuar me tremujorin e dytë. Megjithatë, me bazë vjetore krahasimi, paga mesatare në ekonomi u rrit me rreth 2.4%. Në vlerë monetare, një i punësuar paguhej rreth 1200 lekë më shumë krahasuar me një vit më parë. Këto

të dhëna tregojnë se rritja e pagave është ende e ngadalë, sidomos e zhveshur nga efekti i inflacionit. Në terma realë, paga mesatare në tremujorin e tretë u rrit me vetëm 0.2%. Sipas dhënave nga INSTAT, mësohet se pagesat in-

formale janë ulur në vitet e fundit, por ato ngelen të pranishme, sidomos për nivelet më të larta të pagave, ku kosto e deklarimit është më e madhe. Ky është një nga faktorët pse paga mesatare është më e lartë në sektorin pub-

lik. Sipas INSTAT, në shtet paga mesatare është rreth 60,500 lekë në muaj, 20% më e lartë krahasuar me pagën mesatare për të gjithë ekonominë. Rritja e pagave është një ndër faktorët kryesorë të rritjes së kostove të prodhimit dhe të presioneve inflacioniste në ekonomi. Banka e Shqipërisë në raportin e fundit të politikës monetare vlerëson se këto presione janë në rritje.

Ish-ministri i Financave propozon draftin për uljen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar me 14%

Propozimi i Ahmetajt: Mediat 'online', TVSH 6% për reklamat

Projektligji mbërrin për shqyrtim në Kuvend

Ish-ministri i Financave, Arben Ahmetaj, ka propozuar ndryshimin e ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, duke kërkuar që TVSH-ja për median në internet të jetë në masën 6% dhe jo në masën 20%. Propozimi për uljen e TVSH-së me 14% është argumentuar me faktin ky propozim do të mundësojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues midis ofruesve të shërbimeve audiovizive dhe elektronike. "Përmes këtij projektligji, propozohet që shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6%, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike", shkruhet në propozimin që u publikua në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

PROPOZIMI

Propozimi i Ahmetajt për të ndryshuar një ligj që ai vetë ndihmoi të formulojë vetëm tre muaj më parë, vjen pasi mediat 'online' u gjendën në pasiguri tati-more në fillim të këtij viti pikërisht për shkak se më parë, media konsiderohej e përfshuar nga TVSH-ja, ndërsa në ndihmë të disa televizioneve, qeveria vendosi TVSH në masën 6% për mediat audiovizuale. Kjo do të thotë se televizionet që do të blejnë pajisje për efekt të procesit të dixhitalizimit, do të mund të zbrisin nga llogaria e tyre TVSH-në e paguar në blerje, duke pasur efekt pozitiv në bilancet e tyre.

RELACIONI

Në relacionin për projektligjin "për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, 'për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar" propozohet që shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6%, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike. "Ky propozim do të mundësojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues midis ofruesve të shërbimeve audiovizive dhe elektronike. Aktualisht media elektronike dhe ofruesit



Ish-ministri i Financave, Arben Ahmetaj

e shërbimit të publikimeve elektronike, në skemën e shkallës së reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar", - thuhet në relacionin që shoqëron draftin. "Në zbatim të parimeve të vendosura përmes ligjit nr. 92/2014 'Për Tatimin mbi

it të publikimeve elektronike, në skemën e shkallës së reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar", - thuhet në relacionin që shoqëron draftin. "Në zbatim të parimeve të vendosura përmes ligjit nr. 92/2014 'Për Tatimin mbi

Vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", subjektet që kryejnë imë të përfshutara, nuk mund të zbrisin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbrisin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import në këtë rast është kosto për ofruesit e këtyre shërbimeve. Paketa fiskale e miratuar në vitin 2018, përmes së cilës u miratuan edhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pati për qëllim ndër të tjera, lehtësimin e investimeve në funksion të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet). Kështu, furnizimi i shërbimit të reklamave nga media audiovizive nuk do të trajtohet me si një furnizim i përfshuar, por si furnizim i tatueshëm me shkallën e reduktuar të TVSH-së prej 6 për qind", - thuhet në relacion.



Raporti për 9 muaj, 2800 biznese ulin qepenat

Rreth 2819 biznese kanë mbyllur aktivitetin në 9 muaj të vitit 2018 vetëm në kryeqytet. Të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore tregojnë se 1775 prej këtyre subjekteve që janë mbyllur gjatë periudhës janar-shtator 2018 i përkasin kategorisë kryesore, që përbëjnë dhe shifrën më të lartë, ndërsa pjesa tjetër janë sekondare. Po të analizojmë sipas llojit të aktivitetit, vihet re se shifra me pakicë është ajo që ka dalë më së shumti nga tregu gjatë kësaj periudhe, ku janë plot 1448 subjekte të mbyllura, të ndjekura nga njësi shërbimi, si bare, restorante, hotele me 714 subjekte dhe më pas në një numër më të vogël renditet transporti me 231 subjekte të mbyllura, shifra me shumicë me 2017 subjekte dhe njësi prodhimi, ku janë regjistruar 91 biznese që kanë dalë nga tregu. Ndërsa lloji i aktivitetit që rezultoi me zero mbyllje janë ambulancat që kanë vijuar të jenë stabile në treg.

"Air Albania", firmoset marrëveshja financiare trepalëshe, brenda 10 ditësh certifikimi

Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, Belinda Balluku dhe drejtori i Bordit dhe Komitetit Ekzekutiv të "Turkish Airline", Iker Ayc bënë të ditur dje se është nënshkruar marrëveshja financiare trepalëshe për kompaninë ajrore shqiptare "Air Albania". Në fjalën e saj, ministrja nënvizoi se gjatë kësaj kohe "Air Albania" ka qenë në proces trajtimi, testimesh teknik dhe hartimit të doku-

mentacionit të nevojshëm për certifikimin. "Kur fli-tet për një kompani që është mbajtëse e flamurit, flasin për një proces serioz. 'Air Albania' ka kaluar në fazat që duhen për t'u certifikuar prej disa kohësh. Është punuar për të kaluar fazën e trajnimeve, për të konsoliduar fazën e testeve teknike, për të prodhuar të gjitha letrat dhe manualët që çojnë drejt certifikimit dhe sot ishim për të kolauduar marrëveshjen financia-

re mes tri palëve që hap rrugën për certifikimin nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Ky proces do të ndodhë në vijim në harkun e një jave apo 10 ditëve", tha Balluku. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i "Turkish" nënvizoi se shumë shpejt "Air Albania" do të jetë në qiell. "Jemi të lumtur që jemi këtu. Prej disa kohësh po punojmë për infrastrukturën e 'Air Albania'. Ka përfunduar procesi teknik dhe jemi në fazën kur po



përmbillet procesi total. 'Air Albania' do të jetë së shpejti në qiell. Sot nënshkruam dokumentet e partneritetit dhe kthehem me

shpresë në Stamboll", tha Ayci. Në 16 qershor të vitit të shkuar, qeveria përcaktoi për herë të parë procedurat për krijimin e shoqërisë "Air Albania", e cila do të operojë në fushën e transportit ajror. Tre ortakët e saj, sipas të njëjtit vendim, janë "Albcontrol", sh.a., që përfaqëson palën shtetërore shqiptare dhe dy subjekte të tjera, "Turkish Airlines" dhe "MDN Investment", sh.p.k. Sa u përket aksioneve, sipas regjistrimit në QKR të pakët 10 për qind janë të "Albcontrol", 41 për qind të "MDN Investment" dhe 49 për qind të "Turk Hava Yolları A.O".

Ndërtimet e paligjshme, miratohet fondi për pagesën e tokës së zënë pa leje

Qeveria miraton kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. ALUIZNI publikon listën me 753 pronarë që përfitojnë fondin e miratuar dje. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m² është 522 842 426,65 lekë.

VENDIMI

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, përcakton më tej vendimi. Ndërkohë, ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

VKM-ja/ ALUIZNI jep 552 mln lekë për kompensimin e 753 pronarëve

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë

APLIKIMI PËR TË MARRË PARATË DHE DOKUMENTET

- ATP-ja, në zbatim të VKM nr. 383/2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" i ndryshuar, procedon si më poshtë:
 1. Njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.
 2. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.
 3. Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë paraqet pranë ATP-së gjithë dokumentacionin e lartpërmendur.
 4. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës.
 5. Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura.
 6. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës: a) nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi; b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen; c) njofton kërkuesin që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mos përfshirjes.

Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi. **APLIKIMI**
Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së brenda 30 ditëve nga data e

përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes. Sub-

jekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimit për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimitve të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokurë e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pa varësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

| Numri i Pronarëve që kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|----------------------------------|------------------------|---------|----------|---------------|----------------|--------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m ²) | Çmimi (leke/m ²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| | Mediha | Demir | Libohova | | | | | |
| | Qefalije | Demir | Juba | | | | | |
| | Jalldiz | Demir | Hydi | | | | | |
| | Ferzilet | | Spahiu | | | | | |
| | Minerva | Hysni | Jenisher | | | | | |
| | Rafete | | Bineri | | | | | |
| | Suat | Bektash | Tare | | | | | |
| | Djana | | Qesko | | | | | |

| | | | | | | | | |
|--|-----------|---------|----------|-----|-----|--------|-------|--------------|
| | Fuat | | Libohova | | | | | |
| | Kadri | | Libohova | | | | | |
| | Xhenan | | Qesja | | | | | |
| | Armina | | Vokopola | | | | | |
| | Saviola | | Vokopola | | | | | |
| | Merita | | Vokopola | | | | | |
| | Roland | | Fuga | | | | | |
| | Peqere | | Fuga | | | | | |
| | Djana | Ali | Bulli | | | | | |
| | Dilfiruze | Ali | Toptani | | | | | |
| | Fatmira | Adem | Peqini | 125 | 3/4 | 309.00 | 7.745 | 2,393,205.00 |
| | Mediha | Demir | Libohova | | | | | |
| | Qefalije | Demir | Juba | | | | | |
| | Jalldiz | Demir | Hydi | | | | | |
| | Ferzilet | | Spahiu | | | | | |
| | Minerva | Hysni | Jenisher | | | | | |
| | Rafete | | Bineri | | | | | |
| | Suat | Bektash | Tare | | | | | |
| | Djana | | Qesko | | | | | |

| Numri i Pronarëve që kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|----------------------------------|------------------------|-------|----------|---------------|----------------|--------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m ²) | Çmimi (leke/m ²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| | Djana | | Qesko | | | | | |
| | Fuat | | Libohova | | | | | |
| | Kadri | | Libohova | | | | | |
| | Xhenan | | Qesja | | | | | |
| | Armina | | Vokopola | | | | | |
| | Saviola | | Vokopola | | | | | |
| | Merita | | Vokopola | | | | | |
| | Roland | | Fuga | | | | | |
| | Peqere | | Fuga | | | | | |
| | Djana | Ali | Bulli | | | | | |
| | Dilfiruze | Ali | Toptani | | | | | |
| | Fatmira | Adem | Peqini | 126 | 3/4 | 471.80 | 7.745 | 3,654,091.00 |
| | Bujare | | Troçi | | | | | |
| | Dylbere | | Biturku | | | | | |

| | | | | | | | | |
|--|--------|--|---------|-----|-------|--------|-------|--------------|
| | Rukije | | Biturku | 127 | 1/168 | 448.00 | 7.745 | 3,469,760.00 |
| | Ëjete | | Biturku | | | | | |
| | Atije | | Biturku | | | | | |

| | | | | | | | | |
|--|----------|--------|------------------------|---|------|-------|--------|--------------|
| | ILIR | NAMIK | DAIU | | | | | |
| | SUZANA | QEMAL | MATRAXHIU(ZA I QSENIA) | | | | | |
| | BARDHYL | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| | SHKELQIM | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| | ENGJELL | QEMAL | MATRAXHIU | | | | | |
| | ZEGJINE | BEQIR | DAIU | | | | | |
| | BLEGINA | NAMIK | HADO(DAIU) | | | | | |
| | FATMIR | ISMAIL | DAIU | | | | | |
| | BESNIK | ISMAIL | DAIU | | | | | |
| | ARDIANA | ISMAIL | LUFTA(DAIU) | 8 | 9/23 | 286.6 | 12,764 | 3,658,162.40 |

| Numri i Pronareve e qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|------------------------------------|------------------------|---------|--------------|---------------|----------------|--------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m ²) | Çmimi (leke/m ²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 440 | DORINA | BARDHUL | HASEQIU | | | | | |
| 441 | KRESHNIK | FRANK | UCAJ | | | | | |
| 442 | FLORA | XHAFERR | HASEKIU(UCI) | | | | | |
| 443 | FISNIK | XHAFERR | HASEKIU | | | | | |
| 444 | ENGJELL | XHAFERR | HASEKIU | | | | | |
| 445 | FEIME | SKENDER | HASEQIU | | | | | |
| 446 | MARSELA | BARDHUL | HASEQIU | | | | | |
| 447 | DORINA | BARDHUL | HASEQIU | | | | | |
| 448 | KRESHNIK | FRANK | UCAJ | 61 | 1415/258 | 110.7 | 12,764 | 1,412,974.80 |

| | | | | | | | | |
|-----|----------|---------|------------------|----|---------|--------|--------|---------------|
| 449 | ABDULLA | DERVISH | BANJA | | | | | |
| 450 | BASHKIM | OSMAN | GJEVORI | | | | | |
| 451 | ENVER | SHEFKI | VRAPI | | | | | |
| 452 | FUAT | DERVISH | BANJA | | | | | |
| 453 | HEDUE | SHEFKI | GOGA(VRAPI) | | | | | |
| 454 | KBAL | DERVISH | LISI (BANJA) | | | | | |
| 455 | ISMAIL | DERVISH | BANJA | | | | | |
| 456 | ISUF | SHEFKI | VRAPI | | | | | |
| 457 | KUTIM | SHEFKI | VRAPI | | | | | |
| 458 | LILJANA | SHEFKI | VRAPI | | | | | |
| 459 | LINDITA | HIOMET | SPAHIU | | | | | |
| 460 | NAZF | DERVISH | BANJA | | | | | |
| 461 | NDRICIM | OSMAN | GJEVORI | | | | | |
| 462 | PULLUMB | HIOMET | SPAHIU | | | | | |
| 463 | RIZA | HIOMET | SPAHIU | | | | | |
| 464 | SHEFIKAT | RIZA | ZHUPAN(SPAHIU) | | | | | |
| 465 | SHPRE SA | HIOMET | SHYPHEJA(SPAHIU) | | | | | |
| 466 | URIM | OSMAN | GJEVORI | 62 | 1380/29 | 232.2 | 12,764 | 2,963,800.80 |
| 467 | HAXHI | | ASLLANI | | | | | |
| 468 | XHAFERR | | HAXHIASLLANI | 63 | 1380/30 | 114.9 | 12,764 | 1,466,583.60 |
| 469 | | | | | | | | |
| 470 | DEUMET | MEHMET | BANGA | 64 | 303/1 | 836.40 | 12,764 | 10,675,809.60 |
| 471 | GAZMEND | DEMIR | PALLOSHI | | | | | |

| | | | | | | | | |
|-----|----------|-------|-------------------|----|----------|--------|--------|--------------|
| 472 | REFIK | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 473 | SHEFIKAT | AHMET | GARUNJA(PALLASHI) | | | | | |
| 474 | LIRI | AHMET | LABINOTI | | | | | |
| 475 | EMINE | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 476 | AGIM | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 477 | HAMDI | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 478 | SHPETIM | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 479 | FATIME | DEMIR | KARADAKU | | | | | |
| 480 | ALBANA | DEMIR | BALLICI | 65 | 1415/267 | 48.60 | 12,764 | 612,672 |
| 481 | GAZMEND | DEMIR | PALLOSHI | | | | | |
| 482 | REFIK | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 483 | SHEFIKAT | AHMET | GARUNJA(PALLASHI) | | | | | |
| 484 | LIRI | AHMET | LABINOTI | | | | | |
| 485 | EMINE | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 486 | AGIM | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 487 | HAMDI | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 488 | SHPETIM | AHMET | PALLOSHI | | | | | |
| 489 | FATIME | DEMIR | KARADAKU | | | | | |
| 490 | ALBANA | DEMIR | BALLICI | 66 | 1415/268 | 771.80 | 12,764 | 9,851,255.20 |

| | | | | | | | | |
|-----|---------|-------|---------|----|---------|--------|--------|--------------|
| 491 | HASAN | | KILA | 67 | 1380/11 | 737.10 | 12,764 | 9,408,344.40 |
| 492 | ARTAN | QEMAL | DARDHA | | | | | |
| 493 | VIOLETA | QEMAL | KADA | | | | | |
| 494 | MIMOZA | AVNI | ÇABIRI | | | | | |
| 495 | ARIAN | AVNI | STAROVA | 68 | 1380/16 | 488.2 | 12,764 | 6,231,384.80 |

| | | | | | | | | |
|-----|----------|----------|---------------|----|--------|----------|--------|---------------|
| 496 | NAFTALIA | | DOKSANI | | | | | |
| 497 | ZANA | LLAZAR | STATHI | | | | | |
| 498 | LILJANA | LLAZAR | KELLIÇI | | | | | |
| 499 | VERON | HASAN | DUMA | | | | | |
| 500 | MELITA | HASAN | DUMA | 69 | 132/14 | 1,490.90 | 12,764 | 19,029,847.60 |
| 501 | LAZER | DHIMITER | PAPAJANI | | | | | |
| 502 | VENEMIN | | JOSIFI | | | | | |
| 503 | ANILA | | DEMIR(JOSIFI) | | | | | |
| 504 | ERNEST | | NASTO | | | | | |

| Numri i Pronareve e qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|------------------------------------|------------------------|-------|-----------------|---------------|----------------|--------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m ²) | Çmimi (leke/m ²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| SAIDE | | | PAJOVA | | | | | |
| ZYBA | | | MUSAJ | | | | | |
| FATMIR | | | BESNIKU(KOPIJU) | | | | | |
| ENGJELLU SHE | IBRAHIM | | SHENGJERÇIU | | | | | |
| ZYHRA | | | GREÇA | | | | | |
| MAKBULE | | | ZENELHOXH A | | | | | |
| HYSEN | | | VELENICA | | | | | |
| HIOMETE | | | LABINOTI | | | | | |
| EDISON | | | VELENICA | | | | | |
| SHEFOET | | | TUXHARI | | | | | |
| ILIRJANA | | | STAFA | | | | | |
| MARIA | | | JORGO | | | | | |
| ARTUR | | | MEZINI | 12 | 1328/16/2 | 308.9 | 12,764 | 3,931,056.72 |
| KRENAR | | | MEZINI | | | | | |
| FLUTUR | RAMAZAN | | HOTI | | | | | |
| RAZUJE | SELMAN | | KOPLIKU | | | | | |
| SKENDER | ASIM | | MUÇA | 13 | 1328/22/1 | 110.74 | 12,764 | 1,414,506.48 |
| SAIDE | | | PAJOVA | | | | | |
| ZYBA | | | MUSAJ | | | | | |
| FATMIR | | | BESNIKU(KOPIJU) | | | | | |
| ENGJELLU SHE | IBRAHIM | | SHENGJERÇIU | | | | | |
| ZYHRA | | | GREÇA | | | | | |
| MAKBULE | | | ZENELHOXH A | | | | | |
| HYSEN | | | VELENICA | | | | | |
| HIOMETE | | | LABINOTI | | | | | |
| EDISON | | | VELENICA | | | | | |
| SHEFOET | | | TUXHARI | | | | | |
| ILIRJANA | | | STAFA | | | | | |
| MARIA | | | JORGO | | | | | |
| ARTUR | | | MEZINI | | | | | |

| | | | | | | | | |
|--------------|---------|--|---------------|----|----------|--------|-----------|---------------|
| MANDI | BUJAR | | TOLA | | | | | |
| INDRIT | BUJAR | | TOLA | | | | | |
| FATIME | RAMAZAN | | TOLA | | | | | |
| BEDRUE | OSMEN | | TOLA | | | | | |
| ALBANA | ENVER | | VALERA | | | | | |
| DRITAN | ENVER | | TOLA | | | | | |
| SHEFOET | QAMIL | | TOLA | | | | | |
| NDRIÇIM | QAMIL | | TOLA | | | | | |
| LIRI | QAMIL | | TOLA(SKUQI) | 15 | 83/11 | 472.7 | 12,764 | 6,033,542.80 |
| VANGJEL | ANDON | | MILLO | 16 | 3.5.2029 | 303.1 | 12,764 | 3,868,768.40 |
| ALI | HYSEN | | KOPIJU | | | | | |
| BIHANE | IDRIZ | | ZYMA | | | | | |
| LUMN(LUMTUB) | HYSEN | | VERO(KOPIJU) | | | | | |
| SUZANA | HYSEN | | XHEPA(KOPIJU) | 17 | 1324/1 | 1159.3 | 12,764 | 14,797,305.20 |
| PAOIZE | VELI | | SULO | 18 | 383/117 | 751.5 | 12,764 | 9,592,146.00 |
| PAOIZE | VELI | | SULO | 19 | 383/87 | 335.4 | 12,764.00 | 4,281,045.60 |

| | | | | | | | | |
|-------------------------|---------|--|----------|----|----------|--------|--------|--------------|
| ARDIAN | ZENEL | | TUPI | 32 | 7.1.2005 | 500 | 12,764 | 6,382,000.00 |
| IBRAHIM | | | TOPTANI | | | | | |
| LILJANA | SHERIF | | SHTINO | | | | | |
| ILONA | VASIF | | ZISO | | | | | |
| VIVIANA | PETRIT | | TOPTANI | | | | | |
| QAMIL | HYSEN | | BIÇAKU | | | | | |
| GJINOVEFA | MUSTAFA | | BIÇAKU | | | | | |
| NERADA | HYSEN | | TAUSHANI | | | | | |
| LUM-MIR | SHERIF | | FRASHERI | | | | | |
| RITA | SHERIF | | FRASHERI | | | | | |
| MEHMET SEBAUDIN DERVISH | | | | | | | | |
| BIÇAKU | | | | | | | | |
| AHMET SHYQERI DERVISH | | | | | | | | |
| BIÇAKU | | | | | | | | |
| EVELINA | PETRIT | | QYQA | | | | | |
| SEFEDIN | SHYQYRI | | BIÇAKÇIU | | | | | |
| REFIK | PETRIT | | TOPTANI | 33 | 1356/2 | 492.80 | 12,764 | 6,290,099.20 |

SIGURIMI VULLNETAR PËR FITIMET

Voltiza Duro

Të gjithë të moshuarit që nuk i kanë plotësuar vitet e përcaktuara të punës me kontribute për të marrë pension apo të përfitojnë një masë më të lartë të tij mund të aplikojnë për sigurimin vullnetar. Sot, "Gazeta Shqiptare" publikon kriteret që duhet të plotësojnë të interesuarit për këtë lloj siguri- mi; ku në skemë përfshihen shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri si dhe shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar; ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm; si dhe personat që janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. ISSH bën me dije se edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi ose në rastet kur individit i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare. "Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfitues, sipas rastit, i: pensionit të plotë të pleqërisë; pensionit të pjesshëm të pleqërisë; pensionit të reduktuar të pleqërisë; pensionit të invaliditetit; pensionit të pjesshëm të invaliditetit", thekson ISSH.

FUSHAT QË MBULOHE

Sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në sigurimin vullnetar bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Nëpërmjet sigurimit vullnetar mbulohe katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korent; sigurim vullnetar për periudha të kaluara; sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit. Ndërkohë pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar, ndërsa pensioni i pjesshëm kërkon minimalisht 15 vite

Kufijtë e pagesës dhe tarifat mujore. Kategoritë që mund të aplikojnë për sigurim vullnetar

ISSH: Pensionet e pleqërisë, si të përfitoni më shumë të ardhura

"Cilat janë zbritjet që aplikohen nga parapagimet"

1.5%

ZBRITJE

Parapagesë 3 muaj Pensioni i pjesshëm kërkon minimalisht 15 vite pune me sigurime. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore.



Instituti i Sigurimeve Shoqërore

6%

ZBRITJE

Parapagesë 1 vit "Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 6% mbi shumën për një pagesë vjetore", bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore në faqen e tij zyrtare.

3%

ZBRITJE

Parapagesë 6 muaj ISSH bën me dije se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 3% mbi shumën për një pagesë 6 mujore.

sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. "Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse

do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit Janar); - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të

mbulohe me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohe me sigurim vullnetar)."-theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Gjithsesi pagesat e vitit korent mund të bëhen edhe me shumëfshin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale.

SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguajnë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korent në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë punëmarrësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin, kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin

deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënësi që sigurohet nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page, ndërsa çdo kontribues vullnetar për vitin korent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDDHA TË KALUARA

Sigurim vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar si dhe shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pas universitare është me pagesë. Ndërkohë ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara paguhet nga koha kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar por në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

PERIUDDHA TË KALUARA

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç
- Që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar
- Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pas universitare është me pagesë.
- Ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë.
- Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa.
- Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

Papunësia, problemi më i madh për moshat 20-45 vjeç

Sondazhi/ Shqiptarët: Jemi të varfër ekonomikisht, mërgimi zgjidhja e vetme

Qendra Shqiptare për Qeverisje të Mirë publikoi dje sondazhin e vitit 2018, sipas të cilit papunësia është shqetësimi kryesor i qytetarëve, krahas korrupsionit dhe besimit të ulët tek politika. Sondazhi me 5600 vetë në 18 qytete të mëdha të vendit zbuloi se qytetarët ankohen për varfërinë ekonomike, ndaj shprehin gatishmëri në emigrim, sepse nuk kanë besim tek një e ardh-

me më e mirë. Shqetësimi kryesor i qytetarëve të intervistuar nga 20 - 45 vjeç është papunësia dhe sidomos mungesa e perspektivës për të gjetur një vend pune. Gjatë vitit të kaluar të anketuar dy herë në qershor dhe në dhjetor, afro 60 për qind e qytetarëve pohuan se gjendja ekonomike është më keq se një vit më parë, afro 30 për qind se ekonomia ishte njëlloj si më parë dhe vetëm afro 10 për qind thanë se ekonomia është më mirë. Sondazhi gjeti se papunësia dhe

moszhvillimi ekonomik ndikuan tek niveli i përgjithshëm i të ardhurave familjare. Rënia e të ardhurave bëri që 58 % e qytetarëve nuk arritën të kursejnë asgjë, dhe paguan vetëm detyrimet kryesore dhe ushqimet e përditshme. Gjysmën e dytë të vitit sondazhi zbuloi një rritje të borxheve ose kredive, në pamundësi për të plotësuar nevojat bazike. Sipas studimit, perceptimi i përgjithshëm i opinionit publik është se kemi një rritje të korrupsionit dhe



mungesë serioze të luftës kundër tij. Të pyetur në qershorin e kaluar 2018, se a po luftoj korrupsionin në nivelet e larta, më shumë se gjysma e qytetarëve

(50.77 %) thanë "jo", 18.14 % thanë "po" dhe 31.09 %, thanë se lufta kundër korrupsionit është "vetëm propagandë". Emigracioni vazhdon të mbetet një plagë

serioze, sidomos në moshat 18-45 vjeç. Në dhjetorin e kaluar 44 % e të rinjve pohuan se kanë aplikuar për emigrim, ndërsa rreth 20 përqind thanë se kishin në plan të aplikonin.

Pra, mbi 60% e popullsisë së re në moshë kërkon të largohet. Edhe në sondazhin e vitit 2017, për pyetjen "a e shihni emigrimin si rrugëzgjdhje për problemet tuaja?" afro 67% e qytetarëve thanë "po", kundrejt 33% që thanë "jo". Mbështetjen më të madhe e ka marrë pyetja nëse duhej bërë një veting në radhët e politikës. Afro 94.52 % e qytetarëve thanë "Po", se duhej një veting në politikë, ashtu siç po bëhet për gjyqtarët dhe prokurorët, ndërsa vetëm 5.48 % thanë "jo".

"Ja cili duhet të jetë një nga informacionet për publicitetin e barnave"

Ministria e Shëndetësisë ndalon reklamën për barnat që jepen me recetë nga mjeku

Në listë edhe barnat narkotike dhe psikotrope

Voltiza Duro

Reklamimi i barnave që jepen me recetë nga mjeku, do të ndalohet rreptësisht. Lajmi është bërë me dije ditën e djeshme, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila ka zbardhur pikat e rregullores më të re lidhur me mënyrën e kryerjes së publicitetit të barnave në Republikën e Shqipërisë. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar rregulloren publiciteti i barnave përfshin çdo mënyrë informimi, lidhur me barin, pavarësisht llojit të medias me anë të së cilës do të zhvillohet, me qëllim promovimin e përshkrimit, shpërndarjes, shitjes dhe përdorimit të tij", thuhet në njoftimin e MShMS. Në këtë të fundit theksohet se në rregulloren e miratuar saktësohet se publiciteti drejtuar popullatës, lejohet vetëm për barnat që janë pjesë e listës së barnave pa recetë (barnat OTC). Publiciteti drejtuar popullatës është i ndaluar për barnat që shpërndahen kundrejt recetës së mjekut, dhe për të gjitha barnat narkotike dhe psikotrope, sipas ligjeve në fuqi në RSH.

PUBLICITETI I BARNAVE

Publiciteti i barnave për të cilat është e lejuar t'i drejtohet popullatës, duhet të përmbajë të paktën një nga informacionet e mëposhtme.



Foto ilustruese

"Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar rregulloren publiciteti i barnave përfshin çdo mënyrë informimi, lidhur me barin, pavarësisht llojit të medias me anë të së cilës do të zhvillohet, me qëllim promovimin e përshkrimit, shpërndarjes, shitjes dhe përdorimit të tij"

tohet popullatës, duhet të përmbajë të paktën një nga informacionet e përcaktuara. "Publiciteti duhet të përmbajë: Emrin tregtar të barit dhe emrin EPN të lëndës aktive, kur bari përmban vetëm një lëndë aktive;

Informacionin e nevojshëm lidhur me mënyrën e duhur të përdorimit të barit; Informimin e pacientëve lidhur me leximin e kujdesshëm të fletudhëzuesit ose të udhëzimeve në paketimin e jashtëm ose në

paketimin parësor të barit Rregullorja e re e miratuar përcakton, gjithashtu, edhe mënyrën e publicitetit të barnave përmes internetit", -bën me dije Ministria e Shëndetësisë. Më tej në njoftim nënvizohet se përmbajtja e faqes së internetit duhet të ndahet, sipas kategorive të përdoruesve, në një seksion të destinuar për popullatën dhe në një seksion për profesionistët e kujdesit shëndetësor. Ndërkohë, faqet e destinuara për profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të mbrohen nga një emër përdoruesi dhe fjalëkalimi. Publiciteti i barit duhet të sigurojë që informacioni i transmetu-

INFORMACIONI PËR BARNAT

Publiciteti i barnave për të cilat është e lejuar t'i drejtohet popullatës, duhet të përmbajë të paktën një nga informacionet e mëposhtme.

- Emrin tregtar të barit dhe emrin EPN të lëndës aktive, kur bari përmban vetëm një lëndë aktive;
- Informacionin e nevojshëm lidhur me mënyrën e duhur të përdorimit të barit,
- Informimin e pacientëve lidhur me leximin e kujdesshëm të fletudhëzuesit ose të udhëzimeve në paketimin e jashtëm ose në paketimin parësor të barit Rregullorja e re e miratuar përcakton gjithashtu edhe mënyrën e publicitetit të barnave përmes internetit.

ar të jetë i vërtetë, shkencërisht i provuar, dhe në përputhje me kriteret etike, me qëllim që pacienti të trajtohet në mënyrën e duhur dhe racionale, pa keqorientuar profesionistët e shëndetit kur të rekomandojnë, përshkruajnë ose shpërndajnë barin, por edhe pacientët (përdoruesit e barit), në rastet kur publiciteti i drejtohet popullatës. "Spoti publicitar, i cili

do të aprovohet nga autoriteti shëndetësor përkatës (AKBPM), të ketë gjuhë të pastër shqipe dhe të jetë lehtësisht i kuptueshëm nga popullata të cilës i drejtohet. Këto janë vetëm disa nga përcaktimet e bëra në rregulloren për publicitetin e barnave e publikuar në fletoren zyrtare më datë 12/02/2019 dhe mban Urdhrin Nr.25, datë 17.1.2019", nënvizohet në njoftim.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 648

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 16 Shkurt 2019

NORA ISTREFI

SERISH SHITATZENE? ROBERT BERISHA: „NUK KEMI NE PLAN TA LEME RENENE VETEM



Zbulohet detaji i veçantë

Ndodh e papritura për
RITA OREN,
i vjedhin një shumë të madhe parash



RREFIMI

ALESIA BAMI



E larguan nga "Stop", modelja tregon të vërtetën e punës së re

KLAUDIA PEPA

Balerina në një lidhje të re? "Fotot i bëra vetë, kështu sa për Instagram"



Ndodh e papritura për Rita Orën, i vjedhin një shumë të madhe parash

Jo më larg se dje këngëtares së njohur, Rita Ora i kanë vjedhur një shumë të konsiderueshme parash. Vjedhja ka ndodhur nga kontabilisti Andrew Munday, i cili mashtronte klientët e tij VIP, me profil të lartë. Ai merrte para nga fitimet e këngëtareve dhe personazheve të njohur. 37-vjeçari vodhi paratë e tyre ndërkohë që ishte i punësuar nga firma e kontabilitetit Blue Cube Business Ltd, tha policia. Avokati i këngëtares shqiptare, Graham Shear, tha se një pjesë e mirë e parave që iu morën Rita Orës janë rikuperuar. Shear e konsideroi si "mjafat të turpshme" veprimet e Munday. Ndërkaq Rita ende nuk ka reaguar në lidhje me këtë lajm.



Fejesë si në ëndrra, shfaqen pamjet e propozimit që Genc Prelvukaj i bëri Eni Koçit

Që ata ishin çift ne të gjithë e dinim por që edhe janë fejuar, kjo është risi. Genc Prelvukaj dhe Eni Koçi qenkan fejuar në fshehtësi dhe kanë pritur për ta bërë të ditur lajmin e bukur. Me një dekor shumë romantik, këngëtari është ulur në gjunjë dhe i ka propozuar për martesë partneres së tij. "Momenti më i bukur, në Plavën e bukur, me të bukuren time. 03.11.2018. Eni Koçi po mendonte se skena u ndërta për 'photoshooting', -ka shkruar ai duke treguar të fshehtat e propozimit. Të njëjtat foto i ka publikuar edhe Eni duke shprehur emocionin me disa 'emoji'. Çifti i njohur i showbiz-it e kanë bërë publike lidhjen e tyre pak kohë më parë, megjithëse dyshimet kanë qenë të forta prej kohësh. Kohët e fundit detaji i unazës në gishtin e këngëtares u vu re nga shumë media, të cilat hodhën dyshime për një fejesë të mundshme, por deri sot asgjë nuk ishte pranuar publikisht nga çifti. Tamam si në ëndrra erdhi dhe propozimi, tani mezi presim ta shohim Enin në fustanin e bardhë!



Jo më Kivanc Tatlitug, radhën e ka aktori shqiptar

Së fundmi, aktori me origjinë shqiptare Can Yaman ka fituar çmimin "Aktori në rritje i vitit" në Turqi, pas disa roleve të suksesshme dhe sidomos rolin në serialin "Erkenci Kus". Aktori 29-vjeçar e mori çmimin e madh në mbrëmjen gala të "GQ Turkey Men of the Year", një event që u mbajt në Stamboll. "GQ Men Of The Year" shpërndau çmimet për burrat dhe gratë që spikatën përgjatë vitit 2018. Yaman e nisi karrierën e aktrimit në vitin 2014, por popullariteti i tij u rrit ndjeshëm në vend me serialin "Erkenci Kus" që vijon transmetimin e suksesshëm në Turqi. Paraqitja dhe fiziku në përmirësim të dukshëm i Yaman ka bërë që të zgjerohë bazën e ndjekësve, veçanërisht tek femrat. Sipas medias turke, Yaman ka lindur në Stamboll nga një familje me origjinë shqiptare. Gjyshi i tij ka emigruar në Turqi nga Kosova, ndërsa gjyshja nga Maqedonia. Tashmë është radha e tij të korë sukses dhe të adhurohet nga vajzat nëpër telenovelat turke!


"E lagu s'e lagu", Oriola Marashi tregon më në fund nëse është apo jo më pjesë e OTR

E dhe pse së fundmi marrëdhëniet mes modeles Oriola Marashi dhe reperit Noizy u përfol se ishin krisur pak kohë më pare u mendua se kjo gjë nënkuptoi edhe largimin e saj nga grupi "OTR". Por modelja hedh poshtë spekulimet, duke treguar se vazhdon të jetë pjesë e grupit dhe madje një javë më parë na tregoi se ndjek edhe në koncert Noizy-n. Ajo bëri një postim në Insta Story ku tregoi dashurinë e saj për pjesëtarët e tjerë të "OTR". "Shumë dashuri për çunat, zemra ime është gati të shpërthejë", shkruan Oriola. Dhe rikujtojmë që kjo s'është e vetmja 'gjurmë' që modelja lë për të thënë se është rikthyer në grup. Pak më parë ajo dhe Noizy postuan një foto në Instastory ku dukeshin shumë të lumtur duke treguar kështu se gjithçka iu rikthye normalitetit.



“Sa të vegjël që jeni!” Kiara Tito reason ashpër pas postimit të pavend të ndjekësit

Është e ditur se kur je personazh publik, përveç komplimenteve, duhet të presësh në komente të postimeve edhe njerëz që të kritikojnë apo të bëjnë pyetje të çuditshme. Një gjë e tillë ka ndodhur me moderatoren Kiara Tito, e cila mori një koment të pazakontë nga një prej ndjekësve të saj në Instagram. “E paske kapur një me shumë lek”, shkruan një komentues në një prej postimeve të saj në rrjetin social. “Sa të vegjël që jeni. Më vjen shumë për të qeshur kur lexoj kështu komentesh. Kaq kisha”, i përgjigjet Kiara, shoqëruar me emojiin e qeshur. Në fakt, ky është një nga paragjykimet më të shpeshta që u bëhet femrave të ekranit shqiptar dhe Kiara nuk është as e para dhe as e fundit!



Të gjithë morën trëndafila, por surpriza që i bëri bashkëshorti aktore shqiptare s’ka të paguar

Ditën e Shën Valentinit, aktorja Teuta Krasniqi është lumturuar shumë nga surpriza që partneri i saj Adonis Morina i bëri për festën e Shën Valentinit. Dhe jo! Nuk është një dhuratë luksoze, por një gjest mjaft i thjeshtë dhe mbi të gjitha, i ndjerë. Bashkëshorti i saj ka gdhendur në mes të dy shpatullave një herë e përgjithmonë, syrin e aktore. Teuta vetë ka qenë ajo që e ka bërë publike “dhuratën” përmes një postimi në rrjetin social Instagram. “Trupi është ditari yt dhe tatuazhet janë historia jote. Zemër faleminderit për dhuratën më domethënëse dhe të çmuar ndonjëherë. Ti je historia ime e dashurisë, historia e jetës, Shën Valentini im, t’du!”- shkruan Krasniqi. Një dhuratë vërtetë e veçantë që do mbahet mend përgjithmonë.



Më në fund publikohet kënga e re e Era Istrefit, që padyshim do jetë hiti i verës

Kishim kohë që e prisnim këngën e saj dhe pikërisht këtë të premte këngëtarja me famë botërore, Era Istrefi ka publikuar hitin e ri “Selfish”. Këngëtarja shqiptare vjen në bashkëpunim me dy dj të njohur, Dimitri Vegas & Like Mike. Klipi hapet me këngëtarën që ndodhet e shtrirë në një dysheme të mbushur me gota plastike pas një feste të çmendur që ka organizuar. Këngëtarja mban veshur një kostum të markës Versace dhe për pamjen e saj është kujdesur stilisti i njohur Justin Lynn. Pak ditë më parë, Era prezantoi këngën ritmike në një skene të madhe ku shfaqej duke performuar. Tepër ritmike dhe e fuqishme, jemi të sigurt që kjo do të jetë kënga e preferuar e club-eve në Shqipëri e Kosovë gjatë sezonin veror. Sukseset nuk po ndalin për këngëtarën shqiptare, pasi këtë vit ajo do të performojë edhe në kampionatin botëror të futbollit për femra, që do të zhvillohet më 7 qershor- 7 korrik 2019 në Paris.

Rikthehet fuqishëm Kallashi, del si gangstere në klipin e këngëtarit shqiptar

Se fundmi qarkullonte nëpër media lajmi se Kallashi do të ishte pjesë e videoklipit të ri të Feros. Lajmi u bë i ditur pak ditë më parë nga reperin ndërkaq sot Kallashi postoi një foto nën përqafimin e tij teksa në duar mbanë një kallash. Ajo nuk shkroi asgjë përveç që etiketoi reperin. Projekti del nesër edhe pse ishte planifikuar të lëshohej sot. ‘Baba për ikona’ quhet kënga e Feros për të cilën ai ka premtuar shumë sukses.



Sërish shtatzënë Nora Istrefi? Zbulohet detaji i veçantë

Robert Berisha: Nuk kemi në plan ta lëmë Renenë vetëm



Ajo shfaqet gjithmonë në çdo dalje të sajën në superformë dhe shumë provokuese. Por mesa duket dita e Shën Valentinit ka qenë një nga 'ditët e rrëfimit' për këngëtaresh shqiptare. Në postimin e saj të fundit ajo shfaqet me një fustan mjaft sensual, por që në profil i duket mjaft mirë barku i rrumbullakosur, i cili nuk ka se si të mendohet se ka qenë thjesht një fryrje e momentit. Duke qenë se Nora Istrefi shfaqet gjithmonë e kuruar deri në detaj dhe e shumë elegante e pa pikë fryrje në stomak, një foto e tillë me një fryrje të tillë na bëri shumë përshtypje. E veshur me një fustan të shkurt, ajo i ka vënë në pah këmbët e gjata joshëse dhe trupin superseksi. Nora ka zgjedhur të duket kështu në postimet që ka bërë së fundi në



elegante për natën e festës së të dashuruarve. Kujtojmë nga ana tjetër se në shtator të vitit të kaluar shfaqti një reklamë në faqen e saj në 'Instagram' që s'para shfaq lidhur me një klinikë gjinekologjike në



'Instagram', ndërkaq sigurisht se është bërë kaq



Spitalin Amerikan në Prishtinë. Edhe pse pati insinuata të shumta ajo preferoi të mos reagoje. Ndërkaq para kësaj fotoje kemi shumë dyshime. Nora Istrefi që është e martuar me Robert Berishën, dhe që kanë një vajzë më emrin Rene, dhe planet për ta janë që së shpejti do të sjell në jetë edhe një fëmijë tjetër, ditët në vijim mbetet të konfirmohet se a është shtatzënë apo jo Nora.



Klaudia Pepa në një lidhje të re? Fansat nuk i lënë rehat balerinët

"Pse nuk e shohim më në Itali", dy kërcimtarët që dolën në vend të katërt tek "Amici" në një romancë?

Shumë personazhe të famshëm shqiptarë ose të huaj, morën nga partnerët e tyre dhuratat nga më të ndryshmet, nga ato më tradicionalet tek ato më unikat. Ndërkaq Klaudia Pepa ishte një prej tyre! Balerina e famshme shqiptare, ndau me ne një imazh shumë të veçantë, ku shfaqej e lumtur, me një gotë shampanjë në dorë, e rrethuar me zemra të kuqe, qirinj, lule dhe një atmosferë perfekte ku çdo vajzë do të ndihej si princeshë. Por e kontaktuar nga Klaudia u shpreh hapur se nuk kishte trokitur ende një dashuri e re në jetën e saj. "Çështja e fotos ishte ide e imja, pasi ishte thjesht sa për instagram. Kështu bëjnë shumë influencer të njohur në mbarë botën në raste festash apo tematikash të veçanta, ndaj dhe unë veprova njësoj", ka thënë balerina. Por a të jetë kjo e vërtetë? Vipat e tjerë 'single' nuk kanë paraqitur



një atmosferë të tillë, përkundrazi i kanë bërë një dhuratë vetes, por disa detaje të tjera tërheqin vëmendjen lidhur me një mundësi të mundshme lidhjeje të balerinës me balerinin italian. Për koicidencë si Klaudia dhe Françesko Mariottini dolën të katërtit në radhë në konkursin e Amici në Itali. Një kërcim mjaft sensual i lidhi të dy, por jo vetëm. Në komentet e fansave shqiptarë dhe italianë ishte dikush që thoshte se Françesko nuk shihet më shpesh në Itali si dhe një mundësi lidhjeje midis tyre. Edhe pse të gjitha këto janë aludime, në kërcimin e tyre duket se kishte më tepër se kimi mes kolegësh. "Princi im", i quajtur nga Klaudia mund të jetë jo vetëm koleg, por mbase edhe në të vërtetë, dhe ende nuk i dihet! Por ajo që ne shohim është se vërtetë duket se janë një çift (i vërtetë apo jo) shumë i bukur bashkë!



Modelja: Punova pa kontratë të 'Klan'-i, Saimir Kodra reagon në emision

E larguan nga "Stop", Alesia Bami tregon të vërtetën e punës së re

Pamela Aliaj

Pas një zhurme shumë të madhe, largimi i modeles Alesia Bami nga emisioni "Stop" ka qenë për një kohë të gjatë kryefjala e lajmeve të mediave rozë. Të dyja palët, duke qenë se është kërkuar një reagim, kanë dhënë versionet e tyre. Nga njëra anë modelja thotë se arsyeja ishte për shkak se zhvilloi intervistë tek "Ftesë në pesë" në "Top Channel." Më pas balerina u ftua sërish në "Top Channel" ku deklaroi se tek "Stop" punonte pa kontratë dhe nuk ishte në dijeni të kushteve të punës. Ndërkohë, kjo deklaratë nuk u la me kaq nga ana tjetër. Së fundmi ishte vetë moderatori i "Stop", Saimir Kodra, i cili reagoi duke ftuar vajzat që dinë të kërcejnë që të paraqiten për të qenë pjesë e emisionit dhe po ashtu pohoi se balerinat punojnë me kontratë dhe siguracione. Përpos kësaj, "Stop" tha se Bami nuk ishte aspak korrekte dhe nuk merrte leje në daljet e saj televizive. Por pas valës së pushimit nga puna, Alesia Bami u përfol se do të fillonte punë shumë shpejt tek "E Diell" në Top Channel. Për ta vërtetuar këtë lajm e kemi kontaktuar modelen, e cila ka treguar të vërtetën lidhur me lajmin. Për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", modelja ka thënë se nuk ka nisur ende asgjë konkrete. Për sa i përket pozicionit tek "E Diell" nuk është aspak i vërtetë si lajm. Ndërkohë që nuk m'hoi se është në punë e sipër për të nisur një sezon të ri diku tjetër. Dhe e gjitha mbetet për t'u parë pasi modelja

*Tek "E Diell"?
Ish-velina
rrëfen se ku
do ta shohim
së shpejti*



ta finalizojë kontratën por me siguri që do të jetë në ambientet e Top-it. Ndërkaq kujtojmë se për largimin e saj nuk ishte aspak e vështirë nga ana e "Stop" duke qenë se direkt ditën pasi ajo mori pjesë tek "Ftesë në pesë" të Bieta Sulos, u zëvendësua me dikë tjetër. Balerina që ka zënë vendin e Bamit është me origjinë nga Kumanova. Balerina 19-vjeçare e quajtur Aulona Limani ishte në vend të Bamit direkt mbrëmjen e pushimit nga puna të Bamit. Dhe për të shuar kureshtjen e të gjithëve, gjatë puntatës së asaj nate të emisionit, gazetari Saimir Kodra ka zbuluar për publikun lidhjen e Aulonës me këngëtarin e njohur shqiptar, Ylli Limanin. Siç mund të kuptohet edhe nga mbiemri i njëjtë, ata kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin dhe këtë e ka pohuar edhe vetë Aulona përpara kamerës. Nga ana tjetër, se ku do ta shohim Alesian tanimë presim postimin që së shpejti do të dalë sipas modeles por që dihet se Top-i e sigurtë që i ka gjetur vendin e duhur.



Nga Baby Gee tek Trejsi Sejдини, kush janë çiftet e reja që i dinim 'single'

Shën Valentini, 'serumi' i së vërtetës së VIP-ave

Kush u lidh e kush u nda, njerëzit e famshëm rrëfehen me 'zemër në dorë'

Pamela Aliaj


Edhe pse kanë kaluar dy ditë nga festa e të dashuruarve na ra në sy një element tepër interesant nëpër postimet në rrjetet sociale të VIP-ave tanë. Të gjithë ata që ne i mendonim të lidhur dhe për më tepër e ruanin në fshehtësi lidhjen, na dolën single, ndërkohë që, nga ana tjetër, këta 'single' u rrëfyan më në fund në postimet e tyre duke shfaqur partnerët përkatës. Pastaj në listën tonë të mëposhtme kemi dhe nga ata që s'kanë për ta pranuar kurrë anën e tyre romantike, por ne do të vazhdojmë të shpresojmë se do ta shohim një ditë! Më poshtë ndiqni se si serumi i së vërtetës, që kemi dashur ta quajmë ditën e Shën Valentinit, i bëri VIP-at tanë të rrëfehen.

ÇIFTET E REJA QË 'ZBULOI' SHËN VALENTINI TREJSI SEJDINI

Emri i Trejsi Sejđinut u bë i famshëm kur ajo fitoi kurorën e Miss Universe. Bukuroshja me linjat seksi spikati menjëherë në skenën tonë, e që prej asaj dite shpesh e shohim online me detaje nga e saj luksoze. Duket se historia e dashurisë me partnerin e saj po shkon më së miri, ndaj këtë Shën Valentini, çifti ka zgjedhur ta shijojë nga Bali. Si asnjëherë më parë, Trejsi ka publikuar një foto me partnerin e saj, të cilën e ka fshirë vetëm pas pak minutash. Djaloshi që shihni në foto është i dashuri i saj prej disa vitesh. Në rrethet sociale në Tiranë ai njihet si biznesmen, ndaj dhe të dy e kanë luksin që të bëjnë një jetë përalllore. Dyshja prej disa muajsh ka nisur edhe bashkëjetesën në një nga zonat më elitare të Tiranës.

CAPITAL T

E dashura e re e Capital T "do i bëjë xhelozë" të gjitha fanset e tij! Reperi i njohur Capital T është një artist shumë i dashur për publikun



Me and my one and only partner in crime Salute to you!



dhe vazhdon të jetë mjaft aktiv në rrjetet sociale. Ai përpjet që nëpërmjet postimeve në 'Instagram' të qëndrojnë sa më pranë fansave duke ndarë me ta momente nga jeta e tij e përditshme. Megjithatë, si gjithë personazhet e tjerë, edhe Capitali ditën e ditën e Shën Valentinit ka publikuar një foto për festën e Shën Valentinit. Këngë-

tari është fotografuar me një arush pellushi në krahë, ndërkohë që në përshkrim të fotos ka sqaruar, që ky arush është dashuria e tij. "Bae për ditën e Shën Valentinit", ka shkruar Trimi pranë fotos, e cila është komentuar gjatë, pasi të shumtë janë ata që e kanë pyetur nëse kjo është një dhuratë për të dashurën apo jo.

GENTA ISMAJLI


Genta Ismajli, e cila ndezi rrjetin me fotot me të brendshme. Edhe pse zbuloi shumë nga trupi saj, këngëtarja kosovare nuk zbuloi asgjë nga jeta private. GSH.al ka mundur të mësojë se Genta nuk është më beqare. Prej disa muajsh këngëtarja seksi është në një lidhje me një djalosh që jeton

jashtë Shqipërisë. Dashuria mesa duket është edhe arsyeja që e ka mbajtur larg bukuroshen nga skena. Edhe pse këtë Shën Valentini ka zgjedhur të na zbulojë trupin dhe jo partnerin, bëhet me dije se Genta më në fund ka gjetur dashurinë. E derisa vetë ajo të vendosë të na zbulojë më shumë detaje rreth kësaj historie, ne do të vijojmë të



my text 2019

Lum ata / ato qe dashurojne ...per pjesen tjetër skam c them, thjesht uroj ta gjejne dashurine te pakten nje here ne jete Naten e mire



gërmojmë më shumë për të gjetur djaloshin misterioz.

BABY GEE

BabyGee bën më shumë për të publikuar lidhjen e saj. Këngëtarja e famshme Baby G, e cila po jeton në Londër ka bërë publike lidhjen e saj. Ajo ditën e Shën Valentinit ka postuar një fotografi në llogarinë e saj në "Instagram" ku shihet në krahët e një mashkulli, që për publikun njihet si Limi Hoti, e të njëjtën gjë e ka bërë edhe ai. Ajo shihet shumë e lumtur bashkë në një darkë me muzikë afër të dashurit të saj. Baby G së fundmi ka publikuar këngën e

saj të titulluar "It's me". Baby G, deri më tani është deklaruar 'single', por siç shihet personi në foto ia ka rrëmbyer zemrën këngëtares. Gordana nuk ka zbuluar asgjë më shumë rreth djalit, e megjithatë nuk ka harruar të etiketojë emrin e tij në Instagram. Ai quhet Lim Hoti dhe njihet edhe si miku i ngushtë i reperit Stresi.

ROZA LATI

Roza Lati është e dashuruar dhe e shfaqur në ditën e Shën Valentinit. Përmes një me-

sazhi në 'Insta Story' ajo bën thirrje që të duam më shumë dhe ta shprehim hapur, ndërsa shton: "Boll i dhatë lajme vrasjeje mediave shqiptare". Por urimi për Shën Valentin nuk mund të bëhet asnjëherë vetëm, por në çift. Si rrallëherë ajo pozon me partnerin e saj, që i mbulon fytyrën, ndërsa shkruan: "Unë dhe partneri im i vetëm në krim ju përsëndesim. Dashuria është një luftë e përditshme, por që ja vlen çdo debat dhe çdo lot për atë kohë që shpirti im kërkon për ty dhe i yti për mua". Pavarësisht se ajo nuk e ka pranuar kurrë hapur, burime pranë "Iconstyle.al" zbuluan në shtator të 2018-s se moderatorja është në lidhje me Arbër Treskun, djaloshin me origjinë nga Mirdita.

BEQARË APO TË NDARË STINE

Në fund të vitit të kaluar këngëtarja Stine konfirmoi ndarjen nga nëna e vajzës së tij, Grazia. Pavarësisht se ky Shën Valentin e ka gjetur vetëm këngëtarin, ai ka një

urim për të gjithë ata që e festojnë ditën e të dashuarve. Stine shkruan se duhet të dashurosh të paktën një herë në jetë, ndërsa i drejtohet ditën e Shën Valentinit ndjekësve të tij në 'Instagram' me këtë shprehje: "Lum ata/ato që dashurojnë... Për pjesën tjetër s'kam ç'them, thjesht uroj ta gjejnë dashurinë të paktën një herë në jetë. Natën e mirë". Ish-partnerja e këngëtarit u shpreh pak kohë më parë se, ndarja ishte zgjedhje e tij. Grazia tregoi se, ndryshe nga sa e mendonte, Stine është një baba shumë i përkushtuar.

LORI HOXHA

Lori Hoxha ka marrë dhuratatë këtë mëngjes me një super buqetë me lule me rastin e Ditës së Shën Valentinit. Fashionista e njohur është surprizuar me rastin e Shën Valentinit, ditës së të dashuarve dhe nëse po mendoni se autori është Visi, gaboheni. Personi që i ka dërguar këto lule të mrekullueshme është nipi i saj i vogël London

Noor: "Joji gëzuar Shën Valentinin, do të të dua përgjithmonë", shkruhet në pusullën bashkëngjitur luleve. Nuk e dimë ende nëse Lori ka marrë ndonjë dhuratë nga Visi. Kohët e fundit çifti është përfolur për ndarje dhe ata as nuk i kanë konfirmuar e as nuk i kanë mohuar këto lajme.

NOIZY

Reperi i njohur Noizy na tregon se si po e kalon këtë 14 shkurt. E para dhe më kryesorja, ai na zbulon në mënyrën më epike se Dita e Shën Valentinit e ka gjetur vetëm, pa dikë në krah. Këtë e kemi kuptuar në postimin e tij të fundit në 'Instastory', ku nuk duket se është shumë pro festimit të Ditës së Shën Valentinit. "Ku të mbytem unë ditën e Shën Valentinit!", shprehet ai duke qeshur. Nuk e dimë nëse e ka zënë koka me të gjitha ato postime romantike, por të paktën nuk është larguar nga 'Instagrami', siç premtoi ditën e Shën Valentinit. Reperi i njohur shqiptar, lajmëroi fansat se s'do të jetë shumë aktiv në rrjetet sociale për një kohë të pacaktuar. Noizy ka treguar edhe arsyen në një postim në 'Instagram', ku shkruan se është duke punuar për një album, i dyti në karrierën e tij. "Dua t'u them që po punoj për një album që jetë CD. Në fakt, ky do të jetë Albumi im i dytë me CD. Prandaj s'do të jem shumë aktiv në rrjetet sociale. Do më falenderoni më vonë gjithsesi", -ka shkruar ai.

MAJK

Ditën e Shën Valentinit, në festën e madhe të dashuarve, shumë prej personazheve publikë nuk kanë nguruar të publikojnë dhuratat luksoze që kanë marrë nga të dashurit e tyre. Sikundër, personat e tjerë që Shën Valentini i ka gjetur pa dikë në krah, kanë zgjedhur një mënyrë në dukje perfekte, për t'i bërë qejfin vetes! Këngëtarja i njohur Majk, ka postuar në Instagram një foto të një makine superluksoze, BMW seria 6 gt, të vitit 2018, çmimi i së cilës fillon nga 70 mijë dollarë. Epo, pikërisht me këtë në krah, ka festuar Shën Valentinin Majk-u.

Analiza

e Ditës

Pa punë, pa kursime, pa shpresa, gati për mërgim

"Zëri i Amerikës"

(vijon nga faqja 1)

... dhe besimit të ulët të politikës.

Sondazhi me 5600 vota në 18 qytete të mëdha të vendit zbuloi se qytetarët ankohen për varfërinë ekonomike, ndaj shprehin gatishmërinë për emigrim, sepse nuk kanë besim të një e ardhme më të mirë.

Qendra për Qeverisje të Mirë i kryen këto sondazhe prej disa vjetësh me mbështetjen e fondacionit gjerman "Konrad Adenauer", për të matur perceptimin e opinionit publik mbi qeverisjen dhe nivelin e demokracisë në vend. Shqetësimi kryesor i qytetarëve të intervistuar nga 20-45 vjeç është papunësia dhe sidomos mungesa e perspektivës për të gjetur një vend pune.

Gjatë vitit të kaluar të anketuar dy herë në qershor dhe në dhjetor, afro 60 për qind e qytetarëve pohuan se gjendja ekonomike është më keq se një vit më parë, afro 30 për qind se ekonomia ishte njëlloj si më parë dhe vetëm afro 10



për qind thanë se ekonomia është më mirë.

Sondazhi gjeti se papunësia dhe moszëvillimi ekonomik ndikuan te niveli i përgjithshëm i të ardhurave familjare.

Rënia e të ardhurave bëri që 58% e qytetarëve nuk arritën të kursejnë asgjë dhe paguan vetëm detyrimet kryesore dhe ushqimet e përditshme.

Gjysmën e dytë të vitit, sondazhi zbuloi një rritje të borxheve ose kredive, në pamundësi për të plotësuar nevojat bazike.

Sipas sondazhit, perceptimi i përgjithshëm i opinionit publik është se kemi një rritje të korrupsionit dhe mungesë serioze të luftës kundër tij.

Të pyetur në qershorin e kaluar 2018, se a po luftojnë korrup-

sioni në nivelet e larta, më shumë se gjysma e qytetarëve (50.77 %) thanë "jo", 18.14 % thanë "po" dhe 31.09%, thanë se lufta kundër korrupsionit është "vetëm propagandë".

Emigracioni vazhdon të mbetet një plagë serioze, sidomos në moshat 18-45 vjeç. Në dhjetorin e kaluar 44% e të rinjve pohuan se kanë aplikuar për emigrim, ndër-

sa rreth 20 për qind thanë se kishin në plan të aplikojnë.

Pra, mbi 60% e popullsisë së re në moshë kërkoi të largohet. Edhe në sondazhin e vitit 2017, për pyetjen "a e shihni emigrimin si rrugëzgjdhje për problemet tuaja?" afro 67% e qytetarëve thanë "po", kundrejt 33% që thanë "jo".

Mbështetjen më të madhe e ka marrë pyetja nëse duhet bërë një veting në radhët e politikës. Afro 94.52% e qytetarëve thanë "po", se duhet një veting në politikë, ashtu siç po bëhet për gjyqtarët dhe prokurorët, ndërsa vetëm 5.48% thanë "jo".

Ky tregues, thanë autorët e studimit, dëshmon për pritshmëritë e qytetarëve nga drejtësia e munguar si dhe një apel që pandëshkueshmëria të marrë fund.

Sipas tyre, kjo shifër e lartë tregon se "ka një koalicion të gjerë të qytetarëve, pavarësisht bindjeve politike, që të bëhet një pastrim i politikës nga persona që kanë lidhje me krimin, korrupsionin, abuzimin me ligjin dhe fondet publike.

DIPLOMACI

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, u bëri thirrje presidentëve të Kosovës dhe Serbisë që të punojnë për normalizimin e marrëdhënieve si një hap thelbësor për të ardhmen e tyre.

Thirrjet ishin pjesë e një letre që presidenti Trump i dërgoi presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi me rastin e 11 vjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe një letre dërguar presidentit serb Aleksandër Vuçiç, me rastin e ditës së shtetësisë së Serbisë.

Në letrën dërguar presidentit Thaçi, thuhet se "marrëdhëniet e fuqishme dypalëshe janë të rëndësishme në vizionin e përbashkët të një Kosove dhe Ballkanit Perëndimor të qëndrueshëm, të sigurt dhe të begatë. Tani kur Kosova po fillon dekadën e saj të dytë si një vend i pavarur dhe sovran, unë i inkurajoj qytetarët e Kosovës që të përqendrohen në ruajtjen e parimeve demokratike, në forcimin e sundimit të ligjit dhe në avancimin e mundësive ekonomike dhe tregtare. Më e rëndësishmja, Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet, që është thelbësore për integrimin perëndimor të Kosovës. Ne e shohim njohjen e dyanshme si themel të mar-

rëdhënieve të normalizuara dhe si bazë për çfarëdo zgjidhje gjithëpërfshirëse".

Shtetet e Bashkuara, thuhet në letrë, "u mbesin partner të gjithë atyre të cilët ndajnë këto vlera dhe janë të gatshëm të kryejnë punë të rënda të nevojshme për suksesin e tanishëm dhe të ardhshëm të Kosovës".

Ndërkaq në letrën dërguar presidentit serb, Aleksandër Vuçiç, presidenti Trump thekson se "Shtetet e Bashkuara mbeten të palëkundura në përkrahjen ndaj angazhimit tuaj për të thelluar bashkëpunimin rajonal dhe në veçanti për përpjekjet tuaja për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Ndërsa u takon palëve që të arrijnë një marrëveshje që mund ta mbeshtetë të dytat, vlerësojmë se njohja e ndërsjellë duhet të jetë element thelbësor i normalizimit afatgjatë të marrëdhënieve. Një



marrëveshje e tillë historike me njohje të ndërsjellë në thelbin e saj, do të ndërtonte rrugën për synimet e Serbisë për integrimin evropian dhe rritje ekonomike", thuhet në letrë.

Në dhjetor të vitit që lamë pas presidenti Trump u kishte shkruar të dy presidentëve duke bërë thirrje që të shfrytëzojnë kohën e duhur për të arritur një marrëveshje pajtimi ndërmjet tyre,

duke theksuar se "do të mirëpriste të dy presidentët në Shtëpinë e Bardhë, për të kremtuar atë që do jetë një marrëveshje historike".

Por, bisedimet ndërmjet të dyja palëve mbetën të pezulluara për shkak të tensioneve politike dhe tarifave ndaj mallrave serbe që vendosi qeveria e Kosovës.

Shtetet e Bashkuara disa herë kanë bërë thirrje për pezullimin e tarifave dhe kanë marrë e paralajmëruar veprime dënuese për shkak të refuzimit të qeverisë për ta bërë një gjë të tillë.

Trysnia amerikane ka bërë që të shtohen përpjekjet në Kosovë për të gjetur një zgjidhje që do të shmangte dëmtimin e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara roli i të cilave vlerësohet i pazvëndësueshëm në proceset politike përfshirë edhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës 11 vjet më parë.

Trump, thirrje për njohje të ndërsjellë Kosovë - Serbi

Opinion *i* Ditës

"Nano ik", "Berisha ik", "Rama ik", cili do të qëndrojë?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... grup të njëjtë problemesh dhe më shumë akoma ndanim shqetësime të njëjta në Evropë. Por, duhet thënë se po kalojnë kohët dhe ne mbetemi robër të harxhimit të energjive tona për të hequr ata, për të cilët kemi besuar më shumë. Rasti i Fatos Nanos, Sali Berishës dhe së fundi i Edi Ramës është shembulli më i bukur sesa energji të shumtë kemi humbur me besimet tona politike dhe kemi mbetur në një qerthull, ku nuk dalim dot.

Në rastin e fundit, me togfjalëshin që ka ndërruar vetëm emrin e përveçëm "Rama ik", ne plotësojmë zhgënjimin e ri më të madh dhe ndoshta të radhës.

Projekti i Shqipërisë Demokratike po rezulton një zhgënjim i madh dhe ky dështim, në një farë mënyre, është edhe fundi i besimit për një sistem ekonomiko-shoqëror, që shqiptarët '90 besonin se i takonin plotësisht pas humbjes krejtësisht të një investimi moral gati gjysmë shekullor në sistemin socialist.

Njerëzit që nxorëm për të na përfaqësuar në erën demokratike nuk e zgjidhën kursesi problemën e pronës, themelin, ku mbështet kapitalizmi; tregu i lirë rezultoi i favorshëm vetëm për të pasurit dhe me rregulla loje, që ndërrohen shpesh nga të fortët; kurse meritokracia përfundoi në një nepotizëm dhe klientelizëm të frikshëm. Shqipëria Demokratike nuk ishte asesi kështu në ëndrrat e bukura të vitit '90 të shqiptarëve, ashtu si askush nuk besonte se Shqipëria nuk do kishte logjikën, që të bënte disa rregulla loje dhe do të endej për gati tre dekada në kaos.

Shkaktarët e parë ishin po ata që morën përsipër të drejtonin projektin e madh të Demokratizimit të vendit, të zgjedhurit tanë, duke filluar me Sali Berishën, Fatos Nanon, dhe tashmë me Edi Ramën. Në fund të viteve të tyre, të dy të parët u përzunë me togfjalëshin popullor "...Ik". Dhe, nuk është habi që të kthehen sërish për të riikur sërish.

E gjithë Evropa zien në protesta, që kanë mbushur jo vetëm kryeqytetet e Evropës, por edhe më gjerë. Zhgënjimi i madh është për politikën e liderëve në vende të ndryshme të Evropës dhe mërzia e thellë është se ngado ëndrra evropiane është një e tillë që ka dëmtuar jo vetëm mirëqenien, por edhe dinjitetin e shumë qytetarëve. Tashmë, mbi të gjitha, të pavetëdijshëm për projektin e Evropës me stabilitet dhe demokratike, bash atë që është bërë vetë burim jo stabiliteti



dhe jo vetëm. Dhe, ne shqiptarët e kosovarët po e ndajmë në kurrizin tonë këtë kakofoni, sesi derdhen kërkesa pas kërkesash dhe sesa i vështirë po bëhet ngado procesi i integritetit, ku fuqinë e bëjnë politikanët ekstremistë. Një analist i huaj, Luke Coffey do të shprehej te A.N. se pasojat politike të krizës ekonomike është arsyeja e ngritjes së partive politike të së Majtës dhe të Djathtës

ekstreme, bash ato që e kanë ulur zërin e partive të moderuara politike në një pikë ku zëri i tyre nuk dëgjohet fare ose është kaq i përvuajtur saqë ka filluar të flirtojë deri me lëvizjet ekstreme.

... Shqipëria është një nga rastet, kur politika për shkak të kësaj kakofonie ka humbur busullën, por më keq akoma politika i është nënshtruar populizmit për të mbijetuar si rezultat i mosafritit të alternativave, kurse me parullat ekstreme ka plotësuar vakumin e forcave, që synojnë pushtetin me çdo kusht, duke penguar zhvillimin e reale normale, që tashmë janë degraduar nga vetë politika. Dhe, pasojat, mbesin njerëzit e çoroditur që bërtasin të njëjtin parullë, thjesht duke zëvendësuar emrin e përveçëm... "Ik...". Po cili duhet të qëndrojë vallë?! Ne, me sa duket, nuk e zgjidhim dot.

Shkaktarët e parë ishin po ata që morën përsipër të drejtonin projektin e madh të Demokratizimit të vendit, të zgjedhurit tanë, duke filluar me Sali Berishën, Fatos Nanon, dhe tashmë me Edi Ramën. Në fund të viteve të tyre, të dy të parët u përzunë me togfjalëshin popullor "...Ik". Dhe, nuk është habi që të kthehen sërish për të riikur sërish.

(Homo Albanicus)

HOROSKOPI

DASHI

Do të jeni të mbushur plot emocione gjatë ditës së sotme. Ka gjasa të fleni mosmarëveshje me një prej të afërmeve tuaj ose konflikt me fqinjët. Do të keni fat sa i përket udhëtimeve dhe blejeve. Beqarët e kësaj shenje që dëshirojnë të shmangin vetminë, këshillohen të mos flirtojnë me këdo.

DEMI

Të lindurit e kësaj shenje kanë të gjitha shanset për të kaluar një ditë shumë të gëzuar. Nuk rekomandohet t'i përgjigjeni provokimeve nga persona të ashpër. Lejojeni veten të merrni frymë thellë, kini besim në vetvetë dhe veproni ndaj ëndrrave tuaja.

BINJAKET

Bëni kujdes me lidhjen tuaj romantike. Shmangni presionin dhe fjalët e tepërta. Opsioni më i mirë është të mos bini pre e një konflikti me partnerin/partnerin tuaj. Në fund të ditës do të befasoneni nga një surprizë shumë e këndshme.

GAFORJA

Gaforret do të kalojnë një ditë plot takime duke mos përjashtuar këtu edhe takimet romantike. Mos refuzoni ftesat që mund t'ju vijnë për të takuar miq, për të shkuar në një festë apo në një event kulturor. Do të bëni mirë të ndryshonit mjedis.

LUANI

Disa Luanë do të mërziten nga monotonia e kësaj të shtune. Do t'ju duhet të përshtateni me planet e familjarëve tuaj, të cilët dëshirojnë që të qëndrojnë në shtëpi. Në mbrëmje do të keni mundësi të dilni me miqtë tuaj, me të cilët do të arëtoheni pafund.

VIRGJERESHA

Virgjëreshat duhet të përgjeshin me kujdes rrethin e tyre të afërt. Mund t'i besoni pa kuptuar një personi dinak. Pjesa tjetër ditës do të kalojë pa probleme. Kushtojni vëmendje aktiviteteve fizik.

PESHORJA

Të lindurit e kësaj shenje nuk do të jenë në humor sot. Ka gjasa që të anuloni një plan për një fundjavë, për shkak të dikujt që e ka kërkuar atë. Në mbrëmje gjërat do të ndryshojnë pozitivisht. Do të keni mundësi të ktheheni në atë që ju e konsideroni si qëllimin tuaj kryesor.

AKREPI

Akrepët nuk rekomandohen ta kalojnë këtë të shtunë me punë shtëpie. Bëni mirë t'i lini për një ditë tjetër këto detyra dhe të merrni me diçka më argëtuese. Nëse jeni në kërkim të dashurisë, sot mund të jetë dita juaj me fat.

SHIGJETARI

Duhet të mendoheni më shumë për ide të reja. Kjo do t'ju ndihmojë për projektet tuaja në të ardhmen. Gjithashtu, rekomandohet të jeni më të kujdesshëm në marrëdhënien romantike. Duhet ta shprehni më shumë dashurinë.

BRICJAPI

Mos i refuzoni kërkesat e partnerit/partneres suaj këtë të shtunë. Sa i përket anës financiare, do të jetë dita juaj e duhur. Në mbrëmje do të bëni mirë të relaksoheni dhe të qëndroni pranë familjes.

UJORI

Ka gjasa që të përfshihen nga pesimizmi. Do të bëheni nostalgjik për të kaluarën. Përpiquni që të dilni nga kjo gjendje sa më shpejt të jetë e mundur. Pasditë mund të zhvillonin një takim shumë interesant.

PESHQIT

Gjatë kësaj dite do të bëni hapa përpara. Kjo e shtunë premtan të jetë një ditë plot argëtim, por edhe produktive në të njëjtën kohë. Do të ishte e udhës të punonit në kolektiv.



Kryesuesit luajnë të dielën

Partizani shkon në Laç, shans për t'u ngjitur në +10

Partizani udhëton këtë fundjavë në transfertën delikate të Laçit, një transfertë që i hap serinë një turi të vërtetë force, pasi menjëherë pas sfidës me kurbinasit, të kuqtë do të përballen respektivisht me Flamurtarin, Ti-

ranën, Teutën dhe Kukësin. Pesë sfida të njëpasnjëshme që do të ndikojnë shumë në rrugëtimin e Partizanit të titulli kampion, titull që mungon në gjysmën e kuqe të kryeqytetit prej 26 vitesh. Ndaj, kundër kurbinasve du-

het vëmendje dhe përqendrim për t'u kthyer me pikë të plota në Tiranë, ose minimalisht edhe me një barazim. Transferta e Laçit është gjithnjë delikate për ekipet, teksa edhe në fazën e parë Partizani nuk shkoi me shumë sesa

një barazim 0-0 ndaj bardhezinjve. Por, atëherë Partizani ende nuk kishte shfaqur potencialin e tij, teksa këtë gjë e bëri javë pas jave, duke udhëhequr tashmë me meritë dhe i shkëputur 8 pikë nga ndjekësi më i afërt, Kukësi. Laçi ka vendosur të kënaqë urinë e tifozëve të kuq, duke hapur të gjithë tribunën pas porte, ndërsa nga kryeqyteti do të udhëtojë masivisht dhe lojtari i 12-të i Partizanit, që tashmë e ndjen më pranë se kurrë titullin kampion.

Në "Niko Dovana" mbyllet 2-1. Rexhinaldo kaloi në epërsi Kukësin, Teuta përmbysi me Prognin dhe Arapin

Jeton Selimi

Një ndeshje e çmendur në Durrës, një fitore e jashtëzakonshme e Teutës, që përmbys Kukësin e projektuar për kampion dhe i merr vendin e dytë në renditje. Në "Niko Dovana", tifozët e kampionatit shqiptar kanë shijuar një nga ndeshjet më të bukura të këtij sezoni. Një 90-minutësh që ka kurorëzuar fituese Teutën, e cila tashmë merr vendin e dytë dhe shndërrohet në antagonistin kryesor të Partizanit. Bledi Shkëmbi kishte hedhur nga minuta e parë kroatin Tomislav Bushiq, ndërsa Cungu, sikundër ishte paralajmëruar, la në stol Vasil Shkurtajn për Rexhinaldon. Sfida nis e shpejtë dhe menjëherë Teuta orientohet drejt sulmit, me Kukësin që has vështirësi të fitojë terren. Në minutën e 27-të kemi një pengim në zonë të Kamara nga Xharia, por ndonëse kontakti është evident, kryesori Juxhin Xhaja ka preferuar të vijojë lojën. Në minutën e 37-të do të zhbllokohet sfida, por golin e shënon Kukësi. Një gjuajtje e rreptë e Rexhinaldos nga rreth 20 metra shkon në këndin e poshtëm të Hidit, duke u dhënë verilindorëve epërsinë dhe me këtë rezultat ekipet shkojnë në dhomat e zhveshjes. Edhe pjesa e dytë do të jetë fotokopje e së parës, Teuta këmbëngul, ndërsa Kukësi mbron rezultatin. Në këtë fraksion loje do të jetë skuadra e Cungut, që do të ketë rastin e artë për ta çuar ndeshjen në 2-0, por vetëm Roca mund ta shpjegojë sesi e humbi atë rast përballë Hidit. Shkëmbi shton forcat sulmuese, duke hedhur Latif dhe Teuta menjëherë bën përmbysjen e madhe. Në minutën e 69-të, një gjuajtje e Latif përplasat në dorën e Cucullit dhe Xhaja akordon një goditje dënimi, të cilën e merr përsipër Progni, që do të shënojë një eurogol. Kukësi tronditet dhe do të pësojë golin e dytë. Tjetër goditje dënimi nga Progni, kësaj rradhe harkim në zonë dhe pas amullisë do të shfaqet Renato Arapi, që shënon golin e epërsisë për vendësit. Kukësi do të hidhet i gjithi përpara sepse nuk ka çfarë më të humbasë, ndërsa në kohën shtesë, në goditjen e këndit të parë të ndeshjes, do

Fitore e çmendur e Teutës, Kukësi në kolaps total

Durrsakët ngjiten në vendin e dytë me 39 pikë



të vijë 11-metërshi për verilindorët pas topit të prekur me dorë në zonë nga Osmani. Do të jetë Ulliam Kordero, ai që do të marrë përsipër prentallinë, por Isli Hidi pret deri në momentin e fundit,

duke mos u mashtruar nga braziliani dhe duke pritur këtë 11-metërsh, që sjell një festë të jashtëzakonshme në "Niko Dovana". Teuta fiton dhe feston me të drejtë me tifozët e saj, falë një loje shumë

të mirë dhe një forme të jashtëzakonshme të Isli Hidit. Një fitore që i jep vendin e dytë, ndërkohë Kukësi pëson humbjen e dytë radhazi dhe tashmë te verilindorët situata është e paqartë.

| SUPERLIGA | |
|-----------------------|-------|
| Java e 22-të | |
| Të premtën | |
| Teuta - Kukësi | 2-1 |
| Të shtunën | |
| Tirana - Luftëtari | 17:00 |
| Të dielën | |
| Kamza - Kastrioti | 14:00 |
| Laçi - Partizani | 14:00 |
| Flamurtari-Skënderbeu | 17:00 |

Trajneri i Teutës, Shkëmbi: Komplimente lojtarëve, të vazhdojmë kështu

Shkëmbi është bërë me 'krahë'. Fitorja e Teutës ishte shtëpitë e madhe dhe ky moment duhet shijuar. Në prononcimin pas ndeshjes për "Supersport", ai falënderoi lojtarët për atë që dhanë në fushë: "Fituam një ndeshje të vështirë, por objektivi vazhdon të jetë i njëjtë të arrijmë Europës. Duhet të marrim sa më shumë pikë. Duhet të përmirësohemi edhe më shumë, më pëlqen si luajmë futboll. Jam i kënaqur me Bushiqin, por ai nuk është në 100%, edhe pse ne presim shumë nga ai. Ky ekip po krijon baza të forta për vitin tjetër dhe shpresoj të kemi kohën dhe për vitin tjetër, por duke pasur sukses këtë sezon. Agresiviteti e bën skuadrën të ndjehet më mirë dhe nuk diskutohet që mua më pëlqeu shumë. Edhe pjesa e parë ishte shumë e mirë. Dua t'i komplementoj të gjithë futbollistët, por të gjithë bashkë kemi ruajtur qetësinë edhe pas rezultateve jo të mira. Shpresoj të vazhdojmë kështu".

Trajneri i Kukësit, justifikimi i Cungut: Ishte ditë tersi

Armando Cungu e sheh veten në momentin më të sikleshëm që kur ka mbërritur te Kukësi. Investimet e mëdha të presidentit Gjici nuk po materializohen në pikë dhe Kukësi jo vetëm që ka humbur shumë terren ndaj Partizanit të vendit të parë, por tashmë ka humbur dhe vendin e dytë, të cilin ia ka marrë Teuta. Ndërkohë, pas humbjes, Cungu për "Supersport" u shpreh: **Në avantazh, pastaj vujtë presionin...** Djemtë bënë një lojë të mirë, ishim në ekuilibër edhe cinikë. Kaluam në avantazh. Në të dytën e dinim që do ishim në avantazh, por ishim brenda detyrave. Patëm rastin për ta mbyllur ndeshjen


me Rrocën, por nuk e bëri. Toleruam në mesin e fushës, duke bërë disa faulle të rrezikshme. Kishim Dzarian me temperaturë, edhe Limaj i dëmtuar në kavigjë. Edhe me Tiranën shpërdoruam, por i tillë është futboll. Kukësi i ka fuqitë për të ecur para, për të bërë kampionatin e vet. **Distanca me Partizanin...** Gjithçka mund të ndodhë, kemi qenë edhe më larg dhe kemi ngushtuar diferencat. Kukësi ka bërë një kampionat të mirë dhe kemi bërë ndeshje të mira. Mesfusha nuk kishte rrezik në sulm. Nuk rikuperuat si duhet. Nuk bëtë presion te Teuta... Mesfushorët nuk ishin në

gjendjen e tyre më të mirë. I sakrifikuam deri në një moment dhe isha gati të ndryshoja vendosjen në 20 minutat e fundit. Por, u ndëshkuam dhe nuk kisha më pse të ruaja rezultatin. Durrësi ka potencial në mesin e fushës dhe i druhesha. Ajo ndodhi. Ishte një ditë e tersët për ne. **Kukësi bëri pak për fitoren...** Kemi bërë ndeshje të mira në dy fazat e para. Tani kanë ardhur shumë lojtarë. Në dy ndeshjet e fundit kemi pasur raste, por nuk i kemi mbyllur ndeshjet. **Rexhinaldo jua shpërbleu. Pse e futët në formacion?** E futa sepse isha i bindur që ka gjendje të mirë dhe do



ke krijuar bindjen se me cilin modul i merrni më të mirën ekipit? Ekipi kishte një modul të mirë në fazën e dytë, kur për 6-7 ndeshje nuk pësuam asnjë gol dhe bëmë 5 fitore e një barazim. Ngushtuam diferencën me Partizanin. Me ardhjet e reja menduam të bëjmë një zgjidhje tjetër për t'u dhënë mundësi edhe atyre. E bëmë me Tiranën, edhe në dy ndeshjet e Kupës, edhe sot. Sot më pëlqeu ekipi, por pretendojmë më tepër. Lojtarët që kanë ardhur duhet të rriten më shumë. Duan kohën e tyre, nuk mund të themi që nuk vlen Shkurtaj apo Rroca. Nuk mund t'i kërkojmë maksimumin që tani. **Katër penalti, keni humbur 2. Keni një peng që ia besuat Ulliam?** S'kam asnjë peng. As me Rexhinaldon, as me Ulliam. Ata kanë gjuajtur sistematikisht. Të dy i bëjnë shpesh edhe në stërvitje.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuaret.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.

36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nyja që preu Alekdansdri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akililit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlandë në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lufjes.
19. Castelliito aktor.
20. Inicialat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelilit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialat e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2 | 9 | | | 8 | | 3 |
| 9 | 5 | 4 | | | | | | 1 |
| | | | 2 | 1 | | | | 7 |
| | 9 | | | 6 | 3 | | 7 | 8 |
| 5 | | | 4 | | 8 | | | 1 |
| 4 | 3 | | 7 | 9 | | | | 2 |
| 7 | | | | 3 | 9 | | | |
| | 1 | | | | | 7 | 6 | 5 |
| 8 | | 6 | | 5 | 2 | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 2 | 7 | 1 | 6 | 9 | 5 | 4 | 8 |
| 8 | 9 | 4 | 2 | 3 | 5 | 1 | 6 | 7 |
| 5 | 6 | 1 | 7 | 4 | 8 | 2 | 3 | 9 |
| 4 | 5 | 9 | 8 | 2 | 6 | 7 | 1 | 3 |
| 1 | 3 | 8 | 9 | 5 | 7 | 4 | 2 | 6 |
| 6 | 7 | 2 | 3 | 1 | 4 | 8 | 9 | 5 |
| 2 | 8 | 5 | 4 | 9 | 3 | 6 | 7 | 1 |
| 7 | 4 | 3 | 6 | 8 | 1 | 9 | 5 | 2 |
| 9 | 1 | 6 | 5 | 7 | 2 | 3 | 8 | 4 |

Argëtim filozofik

- Gjembat që të lënduan ishin ato që u përpoqe t'i mësosh të çelin lule.

*- Mos më gjyko para se të më njohësh...
Mos më nënvlerëso para se të më shidosh...
Mos fol për mua para se të flasësh me mua..

*- Njerëzit ndryshojnë për dy arsye... Ose mësuajn shumë dhe duan të ndryshojnë, ose janë lënduar shumë dhe duhet të ndryshojnë.

*- U bëra më i fortë sepse duhej të bëhesha, jam më i zgjuar për shkak të gabimeve të mia, më i

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|---|----|---|----|----|----|---|----|----|----|----|
| 3 | 1 | 7 | 2 | | 7 | 3 | | 13 | | 2 | |
| 2 | 7 | 5 | | | 8 | 4 | 3 | 5 | 7 | 2 | 6 |
| 7 | | 3 | 1 | 9 | 1 | 6 | 5 | 10 | 6 | 2 | 6 |
| 3 | 5 | 8 | 2 | 3 | 5 | 6 | 1 | 7 | 5 | | |
| 12 | 5 | 13 | 5 | 10 | 1 | 7 | | 6 | | 13 | |
| 2 | 7 | 18 | | 5 | 11 | 2 | 6 | 5 | 8 | 2 | 6 |
| 8 | 2 | 6 | 2 | 2 | 2 | 1 | 8 | 5 | 11 | 1 | |
| 1 | 6 | 8 | | 17 | 9 | 5 | 7 | 2 | | 9 | |
| 3 | 1 | 5 | | 8 | 2 | 16 | | 2 | 7 | 1 | |
| 2 | | | 3 | 2 | 6 | 5 | 9 | 2 | | 1 | 13 |
| 6 | 2 | 7 | 2 | | | 3 | | 18 | 3 | 6 | 1 |
| 3 | 4 | 8 | 5 | 19 | 1 | 5 | | | 3 | 5 | 2 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | A | N | A | P | E | | G | R | A | D | E | T |
| U | G | A | R | E | T | | T | E | D | I | | |
| N | T | L | K | A | P | E | L | E | T | | | |
| | H | E | T | I | M | O | R | E | T | N | U | |
| D | E | E | K | O | N | O | M | I | A | L | | |
| I | B | L | A | K | I | M | E | T | K | L | | |
| A | R | I | A | N | A | A | T | A | A | I | | |
| M | E | N | E | S | T | L | A | T | | | | |
| A | U | A | | I | I | L | I | R | E | T | | |
| N | | B | A | N | A | K | A | E | T | | | |
| T | E | E | M | A | K | E | T | N | E | T | | |
| I | D | R | I | T | A | I | D | E | T | E | | |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | A | N | T | T | E | H | A | S | I | A | | |
| E | R | O | K | H | A | R | T | A | T | F | | |
| R | A | T | O | M | R | A | N | O | A | V | A | |
| C | M | E | L | E | M | E | N | T | E | T | | |
| I | E | K | O | N | O | M | I | A | I | R | | |
| M | A | K | I | N | A | T | L | E | K | U | | |
| K | A | P | A | D | A | N | E | T | E | B | A | |
| O | A | K | S | L | I | I | R | | | | | |
| B | A | R | R | A | A | T | O | L | N | I | | |
| A | R | I | E | L | K | R | E | R | E | T | S | |
| M | A | T | B | A | T | E | R | I | N | A | T | |
| A | T | I | L | A | A | S | S | I | T | A | R | |
| S | H | A | K | A | N | H | I | P | O | K | E | R |
| P | A | T | R | G | J | A | K | I | N | I | N | A |
| A | R | I | A | | F | O | R | M | I | T | | |
| A | K | V | I | K | T | I | M | A | T | G | | |
| K | M | A | R | R | E | Z | I | T | E | M | P | |
| M | E | T | E | O | R | I | T | E | T | A | O | |
| R | O | M | A | N | T | I | K | E | T | A | T | L |
| E | T | O | R | E | A | T | M | K | O | | | |
| F | O | R | T | E | D | A | T | I | N | M | U | N |
| A | R | I | E | O | L | E | O | R | A | I | | |
| R | E | A | L | E | T | I | R | A | N | I | A | |
| T | T | L | E | S | M | E | R | A | L | D | A | |

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- lumtur për shkak të trishtimit që kam përjetuar dhe tani më i mençur sepse mësova gjatë rrjedhës së jetës sime.
- - Akoma dhe një ditë arriti në fundin e saj.....
- Çdo e djeshme, dhe një kujtim.....
- Çdo e nesërme, dhe një shpresë....
- - Mos më thuaj se çfarë thanë për mua, më thuaj vetëm se për çfarë arsye ta thanë ty.
- - Mos qaj për të kaluarën, nuk ekziston më. Mos u shqetësoni për të ardhmen, është ende larg. Le të jetojmë të tashmen dhe le ta bëjmë atë të bukur.

